



Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

Koservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës në Dragash



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Plani Zhvillimor Komunal për komunën e Dragashit 2012 – 2022 Vlerësimi Strategjik Mjedisor

Peter Bank

Florian Bemmerlein-Lux

Maria Elena Zuniga Barrientos – Menaxhere e projektit

Dragash, Kosovë nëntor 2012

Përmbajtja

PËRMBAJTJA	2
1 QASJA METODOLOGJIKE	5
1.1 PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL DHE ATLASI I ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM.....	5
1.2 VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR.....	6
1.2.1 <i>Objektet e shqyrtimit</i>	6
1.2.2 <i>Të mirat e mbrojtura</i>	6
1.2.3 <i>Hapat e vlerësimit</i>	7
2 OBJEKTIVAT E MBROJTJES MJEDISORE	8
2.1 OBJEKTIVAT KOMBËTARE TË MBROJTJES MJEDISORE.....	8
2.2 OBJEKTIVAT E MBROJTJES AMBIENTALE TË THEMELUARA NË BASHKIMIN EVROPIAN DHE NË NIVEL NDËRKOMBËTAR.....	10
3 PËRMBLEDHJE E PZH K	12
3.1 VIZIONI PËR DRAGASHIN.....	13
3.2 PARIMET E PËRGJITHSHME DHE SYNIMET AFATGJATA TË PZH K.....	14
3.3 KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR.....	19
3.4 STRATEGJITË E IMPLEMENTIMIT SEKTORIAL DHE PLANET E VEPRIMIT.....	23
3.4.1 <i>Konservimi i natyrës</i>	23
3.4.2 <i>Vendbanimet</i>	25
3.4.3 <i>Ekonomia lokale</i>	26
3.4.4 <i>Rrugët dhe transporti</i>	28
3.4.5 <i>Shëndetësi dhe mbrojtje civile</i>	30
3.4.6 <i>Arsimi</i>	31
3.4.7 <i>Turizmi dhe trashëgimia kulturore</i>	32
3.4.8 <i>Bujqësi</i>	35
3.4.9 <i>Pylltari</i>	35
3.4.10 <i>Energjia</i>	36
3.4.11 <i>Menaxhimi i furnizimit me ujë dhe i ujërave të zeza</i>	38
4 ASPEKTET RELEVANTE TË GJENDJES AKTUALE TË MJEDISIT	39
4.1 TOKA.....	39
4.2 UJI.....	42
4.3 AJRI.....	47
4.4 FAKTORËT KLIMATIK.....	47
4.5 BIODIVERSITETI, PËRFSHIRË FLORËN DHE FAUNËN.....	48
4.5.1 <i>Flora dhe vegjetacioni</i>	48

4.5.2	<i>Fauna</i>	57
4.6	PEJSAZHI	63
4.7	POPULLSIA DHE SHËNDETI	66
4.8	ASETET MATERIALE.....	66
4.9	TRASHËGIMIA KULTURORE DHE NATYRORE PËRFSHIRË EDHE TRASHËGIMINË ARKITEKTURALE DHE ARKEOLOGJIKE	67
5	PROBLEMET MJEDISORE RELEVANTE PËR PKZH.....	68
5.1	ZONAT RELEVANTE PËR BE HABITAT DHE DIREKTIVËN E BE-SË PËR ZOGJTË	68
5.2	PROBLEMET EKZISTUESE.....	70
5.2.1	<i>Menaxhimi i mbeturinave të ngurta</i>	70
5.2.2	<i>Uji dhe ujërat e zeza</i>	70
6	NDIKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS DHE TË MIRAT E MBROJTURA	71
6.1	PARA –VLERËSIMI	71
6.2	VLERËSIMI I DETAJUAR	71
6.2.1	<i>Korniza për zhvillimin hapësinor</i>	71
6.2.2	<i>Konzervimi i natyrës</i>	73
6.2.3	<i>Vendbanimet</i>	74
6.2.4	<i>Ekonomia Lokale</i>	76
6.2.5	<i>Rrugët dhe transporti</i>	78
6.2.6	<i>Shëndeti</i>	80
6.2.7	<i>Arsimimi</i>	81
6.2.8	<i>Turizmi dhe trashëgimia kulturore</i>	81
6.2.9	<i>Bujqësia</i>	83
6.2.10	<i>Pylltaria</i>	88
6.2.11	<i>Energjia</i>	89
6.2.12	<i>Ujësjellësi dhe kanalizimi</i>	91
6.2.13	<i>Marrëdhëniet</i>	94
7	MASAT E PARAPARA PËR TË PARANDALUAR, REDUKTUAR DHE SA MË SHUMË QË ËSHTË E MUNDUR, BARASPESHIMI I EFEKTEVE NEGATIVE	96
8	PËRMBLEDHJE E ARSYEVE PËR PËRZGJEDHJEN E ALTERNATIVAVE	97
9	MASAT MONITORUESE.....	98
10	PËRMBLEDHJE JO-TEKNIKE	99
11	LITERATURA	104
12	SHKURTESAT	105

Lista e figurave

FIGURA 1: ELABORIM I KOORDINUAR I PZHK DHE AZHQ.....	5
FIGURA 2: ELEMENTET E PZHK QË DUHET TË SHQYRTOHEN NË VSM	12
FIGURA 3: HARTA E KORNIZËS SË ZHVILLIMIT HAPËSINOR	20
FIGURA 4: HARTA E TOKAVE TË DRAGASHIT (AZHQ HARTA B4)	40
FIGURA 5: HARTA E EROZIONIT TË TOKËS (AZHQ HARTA A4.1).....	41
FIGURA 6: UJËNDARËSIT NË KOMUNËN E DRAGASHIT	44
FIGURA 7: VLERËSIMI I RESURSEVE NATYRORE TË UJËRAVE (AZHQ HARTA A3.1).....	46
FIGURA 8: DIAGRAMI I KLIMËS PËR DRAGASHIN.....	47
FIGURA 9: VLERËSIMI I VEGJETACIONIT DHE FLORËS (AZHQ HARTA A1.1).....	56
FIGURA 10: VLERËSIMI I FAUNËS (AZHQ HARTA A1.2).....	62
FIGURA 11: SHFRYTËZIMI I TOKAVE TË KONSOLIDUARA (AZHQ HARTA B7.2).....	65
FIGURA 12: HARTA UDHËZUESE PËR KONZERVIMIN E NATYRËS (AZHQ HARTA G1.1).....	69
FIGURA 13: UDHËZUESI PËR BUJQËSI (AZHQ HARTA G2.2)	87

Lista e tabelave

TABELA 1: LEGJISLACIONET KOMBËTARE DHE PLANET E VEPRIMIT QË DUHET TË SHQYRTOHEN	8
TABELA 2: ZONA E RIGJENERIMIT TË RESURSEVE TË UJIT PËR UJËNDARËS	42
TABELA 3: TEMPERATURA MESATARE STINORE NË DRAGASH.....	47
TABELA 4: RËNIET DHE TEMPERATURA MESATARE GJATË PERIUdhËS SË VEGJETACIONIT	48
TABELA 5: BASHKËSITË BIMORE TË IDENTIFIKUARA NË KOMUNËN E DRAGASHIT.....	49
TABELA 6: LISTA E LLOJEVE TË BIMËVE MË TË RËNDËSISHME DHE TË RREZIKUARA	52
TABELA 7: SIPËRFAQA DHE PËRQINDJA E LLOJEVE TË HABITATIT NË HARTA, TË CILAT JANË TË MBROJTURA SIPAS DIREKTIVËS SË BE_SË PËR HABITAT FLORA-FAUNA-.....	53
TABELA 8: SIPËRFAQA DHE PËRQINDJA E LLOJEVE TË VEGJETACIONIT /SHFRYTËZIMI I TOKAVE ME POTENCIAL TË LARTË PËR BIODIVERSITETIN E BIMËVE.....	54
TABELA 9: NUMRAT E SPECIEVE BIMORE TË RËNDËSISHME	54
TABELA 10: SPECIET E ZOGJËVE TË DRAGASHIT TË LISTUARA NË SHTOJCËN E DIREKTIVËS SË BE-SË PËR ZOGJTË.....	57
TABELA 11: SPECIET E FLUTURAVE TË REGJISTRUARA NË DRAGASH ME STATUSIN IUCN TË RREZIKUARA APO TË NDJESHME APO TË LISTUARA NË SHTOJCËN II APO IV TË DIREKTIVËS SË BE HABITAT	58
TABELA 12: AMFIBIET DHE SPECIET E ZVARRANIKËVE TË REGJISTRUARA NË DRAGASH ME STATUSIN IUCN, E RREZIKUAR OSE E NDJESHME NË SHTOJCA II APO IV TË DIREKTIVËS SË BE-SË HABITAT	60
TABELA 13: LLOJET E SHFRYTËZIMIT TË TOKAVE NË PELLGJET E LUMENJVE TË DRAGASHIT	63
TABELA 14: TRASHËGIMIA KULTURORE NË KOMUNËN E DRAGASHIT	67
TABELA 15: REZULTATET E PARAVLERËSIMIT TË STRATEGJIVE SEKTORIALE	71
TABELA 16: VËSHTRIM I STRATEGJIVE DHE GRUPEVE RELEVANTE TË VEPRIMEVE	99

1 Qasja metodologjike

1.1 Plani Zhvillimor Komunal dhe Atlasi i Zhvillimit të Qëndrueshëm

Përveç Planit Zhvillimor Komunal (PZhK), projekti “Konservimi i biodiversitetit dhe menaxhimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të tokës” ka elaboruar një Atlas të Zhvillimit të Qëndrueshëm (AZhQ) për komunën e Dragashit. AZhQ përbëhet nga katër elemente siç është paraqitur në Figura 1. Elaborimi i koordinuar i të dy dokumenteve, të PZhK dhe të AZhQ, jo vetëm se ka siguruar një shqyrtim të plotë të aspekteve mjedisore dhe të qëndrueshmërisë në përgatitje të PZhK që nga fillimi; AZhQ gjithashtu jep të dhëna themelore adekuate për ekzekutimin e Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) të PZhK. Kështu, ky proces është lehtësuar dhe vlerësimi mund të përqendrohet në çështjet thelbësore.




Figura 1: Elaborim i koordinuar i PZhK dhe AZhQ

1.2 Vlerësimi Strategjik Mjedisor

Qasja e aplikuar gjatë Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) të Planit Zhvillimor Komunal për komunën e Dragashit do të ndjekë dispozitat e parashikuara në Ligjin e Kosovës Nr. 03/L-230 mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor, duke pasur parasysh se

1. Një përshkrim shterues dhe analizë e situatës mjedisore dhe e të gjitha të mirave të mbrojtura për shqyrtim në procesin e VSM tanimë është përpiluar në Atlasin e Zhvillimit të Qëndrueshëm (AZhQ) dhe Profili i Komunës;
2. Strategjitë e parashikuara në PZhK janë përpiluar duke pasur parasysh udhëzuesin e ofruar nga AZhQ.

Përmbajtja dhe struktura e dokumentit të VSM do të ndjekë dispozitat e parashikuara në Shtojcën 2 të ligjit të lartpërmendur mbi VSM.

1.2.1 Objektet e shqyrtimit

VSM do të shqyrtojë ndikimet e pritura të objekteve të ndryshme / dokumentet për planifikim të të mirave të ndryshme të mbrojtura ligjërisht. Dokumentet në vijim janë objekte të VSM:

1. Korniza për zhvillim hapësinor
2. Strategjitë për implementim sektorial dhe planet e veprimit
 - a. Konservimi i natyrës
 - b. Vendbanimet
 - c. Ekonomia
 - d. Rrugët dhe transporti
 - e. Shëndetësia
 - f. Arsimi
 - g. Turizmi dhe trashëgimia kulturore
 - h. Bujqësia
 - i. Pylltaria
 - j. Energjia
 - k. Menaxhimi i ujësjellësit dhe i ujërave të zeza
3. Çështje të ndërthurura që rezultojnë nga strategjitë sektoriale

1.2.2 Të mirat e mbrojtura

Të mirat e mbrojtura që duhet të vlerësohen janë (sipas Shtojcës 2 e Ligjit të Kosovës Nr 03/L-230 mbi Vlerësimin Strategjik Mjedisor):

1. Toka,
2. Uji,
3. Ajri,
4. Faktorët klimatik,
5. Biodiversiteti, përfshirë florën dhe faunën
6. Peizazhi
7. Popullsia njerëzore dhe shëndetësia,
8. Asetet materiale,
9. Trashëgimia kulturore dhe natyrore përfshirë trashëgiminë arkitekturore dhe arkeologjike, dhe
10. Marrëdhëniet e tyre

1.2.3 Hapat e vlerësimit

1.2.3.1 Para-verifikimi

Si hap i parë ndikimi i relevancës së përgjithshme i implementimit sektorial dhe planet e veprimit për të mira të ndryshme të mbrojtura ligjrisht do të verifikohen në bazë të një shkalle dy nivelëshe (jo relevante, relevante). Verifikimi do të rezultojë me një qasje të theshtëzuar për vlerësimin e plotë, duke përjashtuar çështjet me pa apo relevancë ose ndikim mjaft të ulur. Verifikimi do të ofrohet duke përdorur një matricë për verifikim (Tabela 15, faqe 71)

1.2.3.2 Vlerësimi i detajuar

Gjatë hapit tjetër do të bëhet një vlerësim i plotë i ndikimeve në të mirat rlevante të projektit për secilën strategji të PZhK.

Bazuar në vlerësimet individuale, do të përpilohet një përmbledhje e ndikimeve të pritura në të mirat e ndryshme të mbrojtura.

2 Objektivat e mbrojtjes mjedisore

2.1 Objektivat kombëtare të mbrojtjes mjedisore

Gjatë ekzekutimit të VSM duhet të kihen parasysh legjislacionet kombëtare, politikat dhe planet e veprimit në vijim:

Tabela 1: Legjislacionet kombëtare dhe planet e veprimit që duhet të shqyrtohen

Dokumentet	të shqyrtohen
<i>Legjislacioni kombëtar</i>	
<u>Ligji i Kosovës për Mbrojtje të Mjedisit</u>	<ul style="list-style-type: none">• Parimi i masave paraprake dhe parandalimi (neni. 6 (4) dhe (5))• Shfrytëzimi i resurseve natyrore (neni. 8)• Vlerat e mbrojtura natyrore (neni. 12)• Planifikimi hapësinor (neni. 27)• Monitorimi mjedisor (neni. 50)
<u>Ligji i Kosovës mbi Mbrojtjen e Natyrës</u>	<ul style="list-style-type: none">• Parimet e mbrojtjes së natyrës (neni. 5)• Implementimi i mbrojtjes së natyrës (neni. 6)• Vlerat e mbrojtjes së natyrës (Kapitulli II, pjesë. Shtojcat 10 – 15, 17)• Implementimi i mbrojtjes dhe i konservimit të natyrës (Kapitulli IV)• Kufijtë dhe regjimi i mbrojtjes (= zonimi)
<u>Draft Ligji mbi Parkn Kombëtar të Maleve të Sharrit</u>	
<u>Ligji i Kosovës mbi Ujërat</u>	<ul style="list-style-type: none">• Parimet themelore (neni. 4)• Parimet e menaxhimit të qëndrueshëm të ujërave (neni. 5)• Shkarkimi i ujërave të zeza (neni. 46)• Hedhja e substancave dhe mbeturinave (neni. 49)• Zonat e mbrojtura të ujit (neni. 52)
<u>Ligji i Kosovës mbi Trashëgiminë Kulturore</u>	<ul style="list-style-type: none">• Masat ligjore dhe të mbrojtjes (neni. 4)• Trashëgimia arkitekturore (neni. 6)• Trashëgimia arkeologjike (neni. 7)• Peizazhet kulturore (neni. 8) -> (Ligji i Kosovës mbi Planifikimin

Dokumentet

të shqyrtohen

Hapësinor (neni. 12)

Strategjitë dhe planet e veprimit

Strategjia Mjedisore e Kosovës

- Objektivat afatgjatë
 - Reduktimi i emitimit të ndotësve përfshirë degradimin dhe dëmtimin mjedisor, si dhe minimizimi apo ndalimi i atyre aktiviteteve ekonomike që janë të rrezikshme për shëndetin e njerëzve dhe për mjedisin;
 - Mbrojtja e biodiversitetit dhe veprimet për mbrojtje të balancit të përgjithshëm ekologjik brenda Kosovës;
 - Shfrytëzimi racional dhe i qëndrueshëm i resurseve natyrore përfshirë tokën bujqësore;
 - Mbrojtja e peizazheve të vlefshme natyrore, siç është parqet kombëtare dhe monumentet.
- Objektivat afatshkurtër
 - Implementimi i legjislacionit ekzistues dhe, aty ku është e nevojshme, harmonizimi i akteve të tjera ligjore të kërkuara me sipas kërkesave të BE sa më shpejt që të jetë e mundur;
 - Integrimi i mbrojtjes mjedisore në të gjitha sektoret, kështu që ajo do të jetë pjesë e të gjitha politikave dhe programeve (zhvillimi i sektorit);
 - Për të vazhduar me integrimin me strukturat mjedisore të BE.

Plani për Veprim Mjedisor i Kosovës

- Objektivi 1: Fuqizimi i Menaxhimit të Sistemit Mjedisor
- Objektivi 2: Investimi në zonat e problemeve kritike, p.sh. mjedisi urban, menaxhimi i resurseve natyrore, trashëgimia kulturore dhe natyrore, rreziqet natyrore
- Objektivi 3: Shtimi i informatave dhe i vetëdijësimit

Objektivat e Planit Lokal të Veprimit për Biodiversitet në Dragash

- (1) Mbrojtja e zonave me vlera të posaçme të biodiversitetit në komunën e Dragashit
- (2) Përfshirja e Parkut Kombëtar
- (3) Mbrojtja e drunjve
- (4) Menaxhimi i qëndrueshëm i parkut kombëtar dhe menaxhimi i të hyrave
- (5) Shtimi i rritjes së peshqëve me specie të ndryshme
- (6) Prandalimi i ndotjes së tokës

Dokumentet	të shqyrtohen
	(7) Mbrojtja e biodiversitetit të tokës
	(8) Mbrojtja dhe shtimi i kafshëve të egra
	(9) Zhvillimi dhe menaxhimi i agro-biodiversitetit të qëndrueshëm
	(10) Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm – turizmi rural
	(11) Eko turizmi
	(12) Zhvillimi i çiklizmit malor
	(13) Zhvillimi i turizmit të gjuetisë dhe peshkimit
	(14) Zhvillimi i turizmit rekreacional
	(15) Parandalimi apo ulja e ndotjes që ndikon në ndryshim të klimës

2.2 Objektivat e mbrojtjes ambientale të themeluara në Bashkimin Evropian dhe në nivel ndërkombëtar

Dokumenti	Të shqyrtohet
<u>Direktivat e BE për Habitata</u>	<ul style="list-style-type: none">Mbrojtja e habitateve dhe e llojeve
<u>Direktiva e BE për zogjtë</u>	<ul style="list-style-type: none">Mbrojtja e llojeve të zogjeve dhe habitatet e tyre specifike
<u>Direktiva e Kornizës për Ujë e BE</u>	<ul style="list-style-type: none">Arritja e statusit të mirë ekologjik dhe kimik për të gjitha ujërat me afat të caktuar kohorAplikimi i qasjes së kombinuar vlerës së limitimit të emtimit dhe standardet e kualitetitTë arrihet mbulesa e harxhimeve të shërbimeve të ujit
<u>Strategjia e BE e Biodiversitetit deri në 2020 (adoptuar në maj 2020)</u>	<p>Vetëm synimet me relevancë për Dragashin të radhitura:</p> <ul style="list-style-type: none">Synimi 1: Deri 2020: të shtohet numri vlerësimit të habitateve në 100%, dhe numri i vlerësimit të llojeve deri 50% nën Direktivat e Habitatatit dhe deri 50% nën Direktivën e ZogjeveSynimi 2: Deri 2020: ekosistemet dhe shërbimet e tyre janë të mirëmbajtura dhe të shtuara me anë të themelimit të infrastrukturës së gjelbërt dhe duke restauruar së paku 15% të ekosistemeve të degraduara.Synimi 3. A) Bujqësia: Deri 2020, të maksimalizohen zonat nën bujqësinë nëpër tërë lëndinat, tokat e punueshme dhe të lashtat e përhershme që janë të mbuluara nga masat e lidhura me biodiversitetin nën PPB (Politikat e Përbashkëta Bujqësore) kështu që të sigurohet konservimi i



Dokumenti

Të shqyrtohet

biodiversitetit dhe të shkaktohet një përmirësim i matshmëm në statusin e konservimit të llojeve dhe të habitateve që varen në ose janë të ndikuara nga bujqësia dhe në ofrim të shërbimeve të ekosistemit siç është e krahasuar në Bazën e EU2010, kështu të kontribuohet në shtimin e menaxhimit të qëndrueshëm.

B) Pyjet: Deri 2020, Planet e Menaxhimit të Pyjeve apo instrumente ekuivalente, në përputhje me Menaxhimin e Qëndrueshëm të Pyjeve (MQP)²¹, janë të gatshme për të gjitha pyjet që janë në pronë publike dhe për sipërmarrjet pyjore mbi një madhësi të caktuar që pranojnë fonde nën Politikën e BE për Zhvillim Bujqësor kështu që të shkaktohet një përmirësim i matshëm në statusin e llojeve dhe të habitateve që varen në ose janë të ndikuara pylltaria dhe në ofrimin e shërbimeve të lidhura me ekosistem siç është e krahasuar me Bazën e EU2010.

3 Përmbledhje e PZhK




Figura 2: Elementet e PZhK që duhet të shqyrtohen në VSM

PZhK përbëhet nga disa nivele planifikimi që duhet të shqyrtohen gjatë VSM. Këto elemente dhe marrëdhëniet e tyre janë prezantuar në Figura 2.

- Vlerësimi i pikës nisëse është vizioni kryesor për zhvillimin e mëtejshëm lokal, i cili është i siguaruar Plani Hapësinor i Kosovës si një kornizë dhe vizion specifik i komunitetit lokal i zhvilluar gjatë një procesi me pjesëmarrje.
- Elementet e dyta të vlerësimit janë parimet e përgjithshme të aplikuar dhe qëllimet afatgjata të formuluar.
- Korniza e zhvillimit hapësinor është e bazuar në vizionin dhe synimet afatgjata zhvillimore duke pasur parasysh karakteristikat specifike lokale dhe kërkesat.
- Njëmbëdhjetë strategjitë sektorale dhe planet e veprimit sigurojnë përkthimin e kornizës me hapat konkretë dhe specifik të veprimit që mund të shkaktojnë pasojat më të rëndësishme mjedisore.

Të gjitha këto hapa dhe elemente janë elaboruar në koordinim të afërt me ndërmjet ekspertëve sektorial duke pasur parasysh të gjeturat dhe rezultatet e Atlasit për Zhvillim të Qëndrueshëm për komunën e Dragashit, i cili është elaboruar paralelisht. Kjo qasje siguron një balans a-priori të lartë ndërmjet kërkesave mjedisore dhe synimeve zhvillimore. Sidoqoftë, kërkohet një Vlerësim Strategjik Mjedisor i plotë.

3.1 Vizioni për Dragashin

Në **Planin Hapësinor të Kosovës**, Dragashi është i njohur si pjesë e rajonit që quhet “Kopshtet e Kosovës”¹, i cili përbëhet nga tri komuna: Suhareka, Dragashi dhe Prizreni si qendër rajonale. Vizioni për “Kopshtet e Kosovës” është i përshkruar si në vijim:

Kopshtet e Kosovës janë zonë e zhvilluar e turizmit kulturor, me një qendër agro-industriale dhe komerciale në Prizren. Rrënjët e traditës së vjetër janë të kombinuara me qeverinë e përgjegjshme lokale, aktivitetet private biznesore, shfrytëzimi i resurseve natyrore dhe njerëzore dhe zhvillimi ekonomik si një qendër moderne ekonomike. Fokus i posaçëm i është dhënë zhvillimit të turizmit dhe bujqësisë. Zonat e kullosave në Dragash dhe Parku Kombëtar Malet e Sharrit konsiderohen si Zona Hapësinore me Interes të Posaçëm.

¹ SPK 2010-2020, p. 121

Nën Planin Hapësinor të Kosovës qëllimet e përgjithshme për Kopshtet e Kosovës janë:²

- Zhvillimi dhe shtimi i infrastrukturës fizike;
- Zhvillimi i një rrjeti atraktiv i qyteteve të planifikuara, me qeverisje të shërbimeve publike në dobi të qytetarëve, me kualitet të shtuar të jetesës së qytetarëve, punësim dhe barazi sociale;
- Zhvillim të fermave;
- Zhvillim ekonomik lokal nëpërmjet promovimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme;
- Zhvillim të turizmit malor dhe kulturor, mbrojtje të trashëgimisë natyrore, kulturore dhe historike.

Gjatë procesit të PZhK është zhvilluar një vizion specifik për Dragashin që është formuluar si në vijim:

Dragashi prezanton dhe ruan traditat. - Porta jugore e Parkut Kombëtar Malet e Sharrit me biodiversitet të pasur, infrastrukturë superiore me shkallë të duhur, ekonomi të qëndrueshme, resurse ekologjike të shfrytëzueshme dhe bio-produkte me kualitet të lartë do të ishte një vend ku të gjithë dëshirojnë të vijnë dhe të pushojnë në natyrën e bukur dhe të pastër. Trashëgimia e pasur kulturore dhe një popullatë e gatshme për të mirëpritur mysafirë me mikrpritje dhe ushqim shtëpiak do të tërhiqte vizitorët vendor dhe ndërkombëtar.

Vizioni është në pajtim me planet dhe politikat kombëtare, posaçërisht me Planin Hapësinor të Kosovës.

3.2 Parimet e përgjithshme dhe synimet afatgjata të PZhK

Parimet e aplikuara në PZhK për Dragashin janë bazuar në dispozitat nga Plani Hapësinor i Kosovës. Këto parime thonë si në vijim:

Integrimi i përgjithshëm dhe qëndrueshmëria

- PZhK mbështetë parimin e qasjes së integruar, përfshirë elementet e infrastrukturës dhe të transportit; zhvillimin ekonomik, social dhe mjedisor, dhe politika tjera strategjike për komunën;
- PZhK mbështetë parimin e ruajtjes së resurseve natyrore dhe të mbështetjes së zhvillimit të qëndrueshëm;
- PZhK promovon zhvillimin ekonomik në fushën e bujqësisë dhe në sektorin e shërbimeve duke ngritur njohuritë dhe asociacionet;
- PZhK promovon ekonominë stabile që do të krijojë mundësi për gjeneratën e vendeve të reja të punës për të gjithë banorët e Dragashit me të drejta të barabarta për të gjithë;

² Ibidem, p. 147

Integrimi dhe përfshirja sociale dhe kulturore

- PZhK promovon zhvillim të barabartë dhe të balancuar nëpër tërë territorin e Dragashit.
- PZhK promovon procesin demokratik të pjesëmarrjes dhe interesat e përbashkëta të banorëve të Dragashit me qëllim të ngritjes së kualitetit të jetesës dhe të mirëqenies sociale;
- PZhK është i bazuar në parimin e ofrimit të qasjes në arsim, shëndetësi dhe në shërbime tjera sociale për të gjithë banorët;
- PZhK ruan traditat dhe identitetin kulturor të rajoneve të Opojës dhe të Gorës;

Integrimi rajonal

- PZhK plotëson largësinë e Dragashit bazuar në parimin e partneritetit dhe të bashkëpunimit ndërkomunal dhe në kontekstin më të gjerë gjithashtu me qëllimin e mbrojtjes, shfrytëzimit racional të resurseve ekzistuese, të cilat i takojnë komunitetit dhe duke nxjerrë përfitime nga projektet e përbashkëta.

Bazuar në vizionin dhe në parimet e mësipërme, PZhK ndjek një grup synimesh zhvillimorë të përgjithshëm dhe specifik për sektorët për Dragashin. Këto janë:

Biodiversiteti dhe konservimi i natyrës, resurset natyrore

- Të mbrohet, konservohet dhe rehabilitohet biodiversiteti floristik dhe faunistik i Komunës
- Mbrojtja e trupave ujqor, pyjeve, lëndinave dhe formacioneve shkëmbore me biodiversitet të posaçëm.
- Parandalimi i ndotjes së ujit, tokës dhe peizazheve.
- Bahskëpunimi me Parkun Kombëtar Malet e Sharrit.
- Të sigurohet dhe të zhvillohet bahskëpunimi tejkuftar me IRJM dhe me Shqipërinë lidhur me përpjekjet e përbashkëta për mbrojtje të biodiversitetit, hulumtimit dhe ekoturizmit.

Pylltari

- Të mirëmbahen dhe zgjerohen zonat e pyjeve ekzistuese dhe të përmirësohet menaxhimi i tyre për të ngritur prodhimin.
- Të minimozohen rreziqet nga ortekët, erozionet dhe rrëshqitjet e tokës me anë të pyllëzimit në zonat më të pjerrëta.
- Të shtohen zonat pyjore në tokat e braktisura dhe në zonat e pjerrëta që nuk janë të përshtatshme për prodhime bujqësore.
- Të themelohet qeverisje e shëndoshë sistemit të pyjeve.
- Lehtëso – sa herë që është e mundur – certifikimin e pyjeve publike sipas standardeve të KSP.
- Të shtohet vjelja ligjore e qëndrueshme si e druve të zjarrit ashtu edhe e druve teknike që do të ndihmojnë në përmirësimin e strukturës aktuale të pyjeve dhe në shtimin e gjenerimit të të hyrave për buxhetin Komunal.
- Të parandalohet prerja ilegale e pyjeve publike.

- Të përmirësohen sistemet e paralajmërimit të hershëm, kontrolli i zjarreve dhe procedurat e zjarrfikjes si dhe masat.
- Të shtohet vetëdijësimi mbi rreziqet nga zjarret.

Bujqësi

- Të përmirësohet performanca ekonomike dhe konkurrentësia e zinxhirit të vlerave bujqësore.
- Të përmirësohet performanca e sistemit të bujqësisë dhe e blegtorisë.
- Të themelohet qeverisje e shëndoshë e sistemit të bujqësisë dhe blegtorisë
- Të promovohet përmirësimi i shfrytëzimit kompatibil me mjedisin i resurseve lokale, organizimi i tyre në zinxhirin e vlerave dhe ngritja e kapaciteteve të konkurrentësisë, ndërsa të mirëmbahet barazia mjedisore afatgjate e qëndrueshme, sociale dhe gjinore.
- Të përmirësohet përpunimi, kualiteti dhe marketingu i produkteve bujqësore.
- Të krijohen të hyra shtesë për fermerët dhe banorët rural, posaçrisht për gratë që çon në përmirësim të standardit jetësor dhe kushteve të punës në zonat rurale.

Infrastruktura rrugore dhe transporti

- Të përmirësohet rrjeti rrugor dhe transporti publik si zgjidhje për të tejkaluar largësinë e Dragashit si tërësi dhe të fshatrave të tij.
- Të përmirësohet mirëmbajtja dhe të merret parasysh mbrojtja e mjedisit si çështje kryesore e zhvillimit të qëndrueshëm. Rrjetet e përmirësuara të rrugëve lokale do të ofrojnë qasje të shpejt, të sigurt dhe të besueshme për të gjitha fshatrat.
- Do të forcohet rrjeti rrugor dhe transporti publik drejt Prizrenit si qendër rajonale, si dhe lidhja me Shqipërinë dhe IRJMR.
- Mirëmbajtja e përmirësuar e rrugëve do të sigurojë se investimet janë afatgjate dhe të qëndrueshme.
- Proceset e planifikimit dhe të vendim marrjes për projektet e rrugëve do të përfshijnë analizat e ndikimit mjedisor dhe do të jenë në pajtim me Parkun Kombëtar të planifikuar.

Vendbanimet

- Të promovohet zhvillimi i mëtejshëm i vendbanimeve në një mënyrë të rregulluar mirë. Të ruhen karakteri individual dhe bukuritë e vendbanimeve si dhe peizazhet përreth.
- Karakteri individual dhe identiteti i fshatit do të mbrohet; vendet e trashëgimisë kulturore duhet të ruhen dhe të restaurohen.
- Të gjitha fshatrat do të kenë zona për një rritje të ndijshme të lagjeve për banim.
- Rregullimi i aktiviteteve private të banimit do të çojë në zhvillim të qëndrueshëm të fshatrave.
- Planifikimi i hapësirës publike në fshatra do të rritet.
- Banorët do të jenë të mbrojtur nga rreziqet natyrore si ortejë, rrëshqitja e gurëve dhe përmbytjet.
- Mjedisi do të jetë i mbrojtur nga ndikimet e vendbanimit.

Ujësjellësi dhe kanalizimi

- Të mborhet kualiteti i ujit të pijshëm dhe i burimeve të ujit.
- Të reduktohen humbjet në sistemet shpërndarëse të ujit të pijshëm dhe të ofrohen shërbime adekuate të ujit dhe të kanalizimit për qytetarët e komunës me tarifa të arritshme. Të gjitha shtëpitë, madje edhe ato që nuk janë të banuara gjatë dimrit, do të lidhen me sistemet e ujësjellësit dhe të kanalizimit.
- Të themelohet një sistem i shëndoshë i operimit të sistemeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit bazuar në objektet ekzistuese infrastrukturore, zgjerim të sistemit dhe mirëmbajtje preventive.
- Të arrihet pranim i shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit bazuar në parimet ekonomike si zgjidhje e vetme e qëndrueshme.
- Të përmirësohet performanca ekonomike e ofruesve ekzistues të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.
- Të promovohet imazhi territorial në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe të tërhiqen resurset e jashtme me qëllim që të shfrytëzohen në mënyrë koherente me udhëzimet e përbashkëta strategjike.

Energjia

- Të promovohet furnizimi me energji elektrike, shfrytëzim të energjisë termale dhe masat për përmirësim të efijencës së energjisë si në sektorin publik ashtu edhe atë privat të komunës së Dragashit.
- Të promovohet furnizimi me energji elektrike i sigurt, i besueshëm, ambientalisht i shëndoshë dhe me kualitet të lartë për të gjithë shfrytëzuesit në Komunë.
- Të shfrytëzohet potenciali për gjenerim të energjisë elektrike bazuar në Teknologjinë për Energji të Ripërtëritshme (TER) për të ngritur furnizimin lokal me energji, të mbështetet ekonomia lokale dhe të evitohen ndikimet negative në mjedis, përfshirë shkaktimin e dëmtimeve në habitate e lumenjve dhe në biodiversitet.
- Përfshirja e TER në kombinim të energjisë së Komunës.
- Të promovohet Efijenca e Energjisë në amvisnitë private dhe në ndërtesat publike.
- Të promovohen iniciativat në mesin e sipërmarrësve dhe kompanive ndërkombëtare dhe lokale apo konsorciume për investim në kapacitete që kanë të bëjnë me energji dhe gjenerim të rrymës elektrike.
- Një Strategji Komunale për Energji do të inkurajojë kompanitë lokale dhe ndërkombëtare për të përfshirë resurset lokale dhe fuqinë punëtore lokale në planet e bizneseve të tyre, me qëllim të mbështetjes së zhvillimit të komunës.

Arsimi

- Të ngritet niveli i arsimit në Dragash.
- Të sigurohet arsimimi i vazhdueshëm dhe aftësimi profesional për burrat dhe gratë pa marrë parasysh sfondin financiar, social apo etnik.
- Të promovohet qasja në nivele më të larta të arsimit për djemtë dhe vajzat.
- Ngritja e mundësive profesionale për të rriturit, përfshirë burrat, gratë, të papunësuarit dhe njerëzit me shkathtësi të vogla.
- Arsimimi do të përmbajë çështjet aktuale (shëndetësi, trashëgimi kulturore, energji, ndotje të ambientit).
- Të themelohen institucione parashkollore për lehtësim të prindërve dhe për përgatitje të fëmijëve për arsimim shkollor.

Mbrojtja shëndetësore dhe civile

- Të optimizohet sistemi i njësive shëndetësore për të ofruar shërbime efikase shëndetësore.
- Shëndetësia dhe jetesa do të pasurohen me pajisje moderne dhe me mbrojtje mirë të organizuar civile.
- Të ngriten shkathtësitë, motivimi dhe numri i stafit mjekësor.
- Të përtërihen pajisjet teknike dhe fizike.
- Të promovohen informatat lidhur me temat e higjienës dhe të shëndetit.

Ekonomia lokale

- Të përmirësohet performanca ekonomike e sistemit të komunës, kryesisht në aspekt të punësimit dhe të të hyrave të popullatës.
- Të valorizohen resurset lokale, të organizohen sipas zinxhirit të vlerave dhe të ngriten kapacitetet, ndërsa të mirëmbahet një mjedis të qëndrueshëm afatgjat, barazi sociale dhe gjinore.
- Të themelohet qeverisje e shëndoshë e sistemit ekonomik.
- Të përmirësohet performanca ekonomike dhe konkurrencësia e zinxhirëve të vlerës.
- Të themelohet një sistem për ofrim të gjerë të shërbimeve për sipërmarrësit, prodhuesit, popullatën, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet publike.
- Të realizohet dhe implementohet një marketing efikas territorial.
- Të përmirësohen kapacitetet në planifikimin e zhvillimit ekonomik.
- Dinamikat prodhuese endogjene do të jenë pjesë kryesore e sektorit ekonomik të Dragashit.

Turizmi dhe trashëgimia kulturore

- Të ruhen asetet natyrore dhe “autenciteti sipas vendit” në çdo pjesë të Komunës.
- Të ngritet vetëdijësimi i brendshëm dhe i jashtëm mbi bukuritë e Dragashit, si një faktor kryesor për zhvillimin ekonomik.
- Të kryhet dhe të mirëmbahet një inventar i aseteve të trashëgimisë kulturore dhe të ndërmerren masa aktive për të mbrojtur, ruajtur dhe rehabilituar trashëgiminë.
- Të implementohet infrastruktura njerëzore dhe fizike e turizmit.
- Zhvillimi turistik do të përfshijë karakteristikat ekzistuese dhe të zbulojë fusha të reja
- Qyteti i Dragashit do të veprojë si një “bazë e kapmpit turistik”.
- Plani Menaxhues i Parkut Kombëtar do të përfshijë elemente të infrastrukturës turistike dhe do të mbështesë realizimin e tij.
- Të ngritet vetëdija në mesin e popullatës mbi trashëgiminë kulturore dhe natyrore.
- Të mirëmbahet trashëgimia kulturore e prekshme dhe e paprekshme e bazuar në kërkime profesionale dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare.
- Komunitetet lokale do të jenë aktivisht të angazhuara në përpilimin dhe implementimin e strategjive lokale kulturore dhe natyrore të turizmit

3.3 Korniza e zhvillimit hapësinor

Korniza e zhvillimit hapësinor formulon strukturën e parashikuar hapësinore dhe organizimin për zhvillimet e ardhshme. Elementet kyçe të zhvillimit të propozuar hapësinor janë të paraqitura në hartën e kornizës për zhvillim hapësinor (Figura 3).

Korniza për zhvillim hapësinor është e përbërë nga disa faktorë. Këto shkurt mund të përmbliidhen si në vijim:

Parimet për zhvillim funksional të vendbanimeve

1. Dragashi si **qendër komunale** duhet të ofrojë shërbime dhe furnizime për tërë komunën në nivelin më të mirë të mundshëm e këto duhet të jenë:
 - Të funksionojë si qendër administrative e komunës;
 - Qendër e arsimit të mesëm dhe e trajnimeve profesionale për burrat dhe gratë;
 - Vendndodhje e Qendrës Kryesore Shëndetësore që ofron kujdesin më të lartë shëndetësor në komunë;
 - Dyqane të specializuara lokale që kënaqin “kërkesat periodike” (p.sh. veshje, pajisje, elektro teknikë);
 - Vend prioritar për sipërmarrjet e reja industriale që duhet të vendosen në zonën komerciale të qytetit të Dragashit
 - Zgjerimi urban i lagjeve amvisnore dhe komerciale; plotësimi urban dhe shtrirja e qytetit të Dragashit do të përfshinin vendbanimet Shajne dhe Lubovishtë si paralagje;

- Sigurimi i infrastrukturës së shërbimeve si furnizimi me ujë, kanalizimi, menaxhimi i mbeturinave etj. në një nivle më të lartë;




Figura 3: Harta e kornizës së zhvillimit hapësinor

- Ofrimi i një transporti adekuat publik për në Prizren dhe për në nënqendrat e komunës.
2. **Nënqendrat** duhet të ofrojnë kushte të mira të jetesës dhe furnizim për fshatrat përreth. Vendbanimet në vijim janë identifikuar si nënqendra duke pasur parasysh strukturat ekzistuese, numrin e banorëve, shtimin gjatë dy dekadave të fundit, strukturat lokale ekonomike dhe

distribuimin e balancuar nëpër tërë komunën: Blaç, Bellobrad, Bresanë, Brezne, Brod, Rapçë dhe Restelicë. Funkcionet e parapara që duhet të ofrohen nga nënqendrat janë:

- Sigurimi i arsimimit për klasat 1-9 në shkollat qendrore
 - Qendrat e mjekësisë familjare të ofrojnë kujdesin bazik mjekësor dhe disa shërbime specialistike
 - Dyqanet lokale të ofrojnë mallra të duhura (ushqim, gazeta) duke kënaqur “kërkesat ditore”
 - Sipërmarrjet të jenë të vendosura në zonat e reja komerciale në nënqendra
 - Të përgatitet një zgjerim i kontrolluar, posaçërisht për shtëpitë
 - Sigurimi i infrastrukturës teknike adekuate siç është uji, kanalizimi, mbeturinat, etj.
 - Lidhje e mirë me rrjetin e rrugëve kryesore
 - Transporti publik për në qytetin e Dragashit
3. **Fshatrat** duhet të ofrojnë kushte të mira jetësore, të furnizuar nga Qendra Komunale dhe nga nënqendrat. Shumica e vendbanimeve janë të klasifikuara si fshatra (22 nga 36); ato do të zhvillohen në një mënyrë organik, do të ruajnë karakterin e tyre tradicional ndërsa do të përshtaten me nevojat jetësore të sotme. Funkcionet e adresuara në nivel të fshatit duhet të jenë:
- Sigurimi i arsimit fillor për klasat 1-5
 - Sigurimi i kujdesit bazik shëndetësor
 - Ekonomia lokale e bazuar kryesisht në bujqësi
 - Sigurimi i infrastrukturës teknike adekuate siç është uji, kanalizimi, mbeturinat, etj.
 - Ca zgjerim i zonave të banimit
4. Disa **fshatra të thella** janë të karakterizuara me një popullsi të vogël, me një numër të vogël të shtëpive, me tendenca dramatike të rënies që nga viti 1981 dhe një numër i ultë i nxënësve dhe ca biznese. Arsyeja kryesore për këtë situatë ka qenë pozita gjeografike e thellë e këtyre fshatrave dhe tradicionalisht qasje e vështirë në rrugë. Për shkak të resurseve të limituara financiare, Komuna nuk do të jetë në gjendje të ndalë këtë proces apo të iniciojë përmirësim të dukshëm, prandaj strategjia e propozuar në PZhK duhet të përqendrohet në mbështetjen e njerëzve, e jo të vendit. Vendbanimet në vijim janë identifikuar si fshatra të thella: Baçka, Dikanca, Leshtani, Orçusha, Xërxe dhe Zlipotoku. Funkcionet që duhet të kryhen në fshatrat e thella janë si në vijim:
- Sigurimi i arsimit fillor për klasat 1-5 në fshat apo në fshatrat fqinje nëse mund të sigurohet transport i sigurt;
 - Sigurimi i kujdesit bazik mjekësor në fshatrat fqinje apo me anë të ambulanteve mobile
 - Zhvillimi ekonomik të jetë i fokusuar në bujqësi
 - Sigurimi i infrastrukturës bazike; implementimi i projekteve infrastrukturore me prioritet më të ultë

- Zgjerim i vokës i zonave të banimit

Funksione shtesë të vendbanimeve brenda kornizës për zhvillim hapësinor

1. **Funksioni ekonomik:** të arrihet zhvillim ekonomik i sektorëve ekonomik siç janë ndërtimtaria, prodhimtaria, tregëtia, akomodimi dhe sektori i energjisë që kërkojnë zgjerim. Në kuadër të kornizës së zhvillimit hapësinor këto aktivitete duhet të fokusohen në kuadër të fushës së shfrytëzimit intesiv të tokës (Figura 3) dhe vetëm të jenë të vendosura në zonat e shfrytëzimit ekstenziv të tokës nën kushte specifike.
 - Ndërtimi duhet të jetë i aglomeruar në zonat ekzistuese urbane dhe në zonat e identifikuara për zgjerim të vendbanimeve.
 - Zonat komerciale ekzistojnë afër qytetit të Dragashit, Pllavës, Buçes dhe Buzezit. Zonat e reja komerciale duhet të zhvillohen në nëqendrat Blaç, Bellobrad, Bresanë, Brezne dhe Restelicë. Si rezultat do të jenë zonat komerciale afër qytetit të Dragashit, në luginën e Opojës me qasje të mirë për në Prizren dhe afër Restelicës me një qasje të mirë me IRJM në perspektivë.
2. **Funksioni turistik:** Turizmi i bazuar në natyrë do të zhvillohet në rajonet Opojës dhe të Gorës duke u përqendruar në qendrat turistike të lidhura me asete specifike turistike. Qendrat turistike do të ofrojnë akomodim dhe informata turistike. Vendbanimet e caktuara për t'u bërë qendra turistike janë Bellobradi, Bresana, Brezna, Zaplluxhja, Brodi, Rapça, Radesha, Restelica, me qytetin e Dragashit si “bazë e kampit” turistik. Zonat turistike evoluojnë nëpërmjet lidhjeve me këto qendra turistike.

Korniza e rrjetit të rrugëve

1. **Përmirësimi i rrjetit të rrugëve dhe i transportit publik** është i nevojshëm për të tejkaluar largësinë gjeografike të Dragashit. Lidhje më e mirë dhe transporti publik do të përmirësojnë jetesën dhe do të mbështesin zhvillimin ekonomik lokal.
 - Më e rëndësishme është përmirësimi i rrjetit rrugor rajonal dhe tejkufitar me Prizrenin, Shqipërinë dhe IRJM.
 - Gjithashtu e rëndësishme është edhe një lidhje lindje-perëndim e luginave të Brodit dhe të Restelicës në rajonin e Gorës.

Korniza zhvillimore e shfrytëzimit të tokës

1. Në bazë të vlerës së lartë të mjedisit të Dragashit, **mbrojtja e biodiversitetit dhe mbrojtja e resurseve natyrore** është një nga parimet kryesore të PZhK. Kjo rrethanë është e reflektuar në parashikimin e zgjerimit të Parkut Kombëtar të Sharrit (PKSh) në komunën e Dragashit. Aspekti i resurseve mjedisore dhe natyrore duhet të konsiderohen se duhet të rriten në menaxhimin e

shfrytëzimit të tokës. Bazuar në konsideratën, territori i komunës mund të ndahet në tri nivele të shfrytëzimit të tokës që gjithashtu reflektohen konceptin e propozuar të zonimit për PKSh.

- **Zona e mbrojtjes strikte:** i lirë nga ndikimi njerëzor, objektivi primar është mbrojtja mjedisore;
- **Zonë e menaxhimit ekstenziv:** Mbrojtja mjedisore është objektivi primar kryesor, por menaxhimi i qëndrueshëm kërkohet për të mirëmbajtur vlerat;
- **Zona e shfrytëzimit intenziv të tokës:** Zonë kryesore e jetesës dhe e punës, shfrytëzim produktiv i tokës krahas me mbrojtjen e mjedisit; mbrojtja e mjedisit është objektivi primar përveç produkteve nga shfrytëzimi i tokës, vendbanimet, zhvillimi komercial dhe turistik.

Zhvillimi i turizmit

1. Zonat kryesore turistike do të jenë:
 - **Lugina e Opojës** (posaçërisht çiklizmi, ecja, udhëtimet); dhe
 - **Malet e Gorës** afër Brodit dhe Restelicës (posaçërisht shëtitja, skijimi, vizita e Parkut Kombëtar).
 - Zonë tjetër turistike mund të zhvillohet afër **Zaplluxhes**, ku është i mundur skijimi.
2. Zgjerimi i planifikuar i Parkut Kombëtar Malet e Sharrit në Dragash ofron mundësi unike për të promovuar turizmin në Komunë duke ofruar mundësi kompatible mjedisore dhe kulturore, shpirtërore, shkencore, arsimore dhe rekreative për vizitorët.

3.4 Strategjitë e implementimit sektorial dhe planet e veprimit

Elementet thelbësore të PZHK për t'u vlerësuar nën VSM janë njëmbëdhjetë strategjitë sektoriale – përmbledhja është limituar në veprimet e identifikuara pasi që vetëm veprimet janë relevante për ndikimin mjedisor të strategjisë.

3.4.1 Konservimi i natyrës

Veprimet (të adaptuara nga Komuna e Dragashit (2010): Plani për Veprim Lokal mbi biodiversitetin në komunën e Dragashit (2011-2015)

A) Të themelohet konservimi i biodiversitetit në zhvillimin e komunës

- A1) Të zhvillohet një udhëzues për konservim të natyrës në Komunë për secilën fushë kryesore (biodiversitet, pylltari, bujqësi, blegtori, menaxhim të ujit, meanxhim të mbeturinave, masa të infrastrukturës siç janë trafiku dhe transporti)
- A2) Të zhvillohen dhe instalohen mekanizma financiar për të mirëmbajtur angazhimin e komunës në mbrojtje të biodiversitetit dhe zhvillim
- A3) Të organizohen dhe të mbështeten fushata të vetëdijësimit për peizazhin dhe varietetin e lartë të pasurisë së biodiversitetit të Komunës nëpër fshatra, shkolla dhe panaire për të promovuar mbrojtjen e natyrës dhe të mjedisit.

Veprimet (të adaptuara nga Komuna e Dragashit (2010): Plani për Veprim Lokal mbi biodiversitetin në komunën e Dragashit (2011-2015)

B) Zgjerimi i planifikuar i Parkut Kombëtar Malet e Sharrit

- B1) Të mbështetet menaxhimi i qëndrueshëm i Parkut Kombëtar (Menaxhimi i Parkut Kombëtar dhe Plani Hapësinor) nëpërmjet Drejtorisë së Parkut Kombëtar
- B2) Komuna duhet të bashkëpunojë me Drejtorinë e Parkut Kombëtar për të optimizuar gjenerimin e të ardhurave dhe për ti shfrytëzuar ato në mënyrë optimale, p.sh. për të balancuar vlerat e shtuara të natyrës
- B3) Themelimi i një Qendre për Biodiversitet në Dragash (një zyrë fushore në rajonin e Opojës dhe një në rajonin e Gorës)
- B4) Të lehtësohet dhe të iniciohet themelimi i partneritetit me komunat tejkufitare për tëlehtësuar dhe promovuar turizmin tejkufitar të Parqeve Nacionale të Maleve të Ballkanit (Sharr, Korab, Deshat)

C) Zonat tjera të mbrojtura dhe planet menaxhuese

- C1) Të mbështetet aktivisht autoritetet kompetente në themelimin e inventareve të detajshme të pikave të nxehta të biodiversitetit brenda Parkut Kombëtar të propozuar (flora, vegjetacioni, insektet, zvarranikët dhe amfibiet)
- C2) Aktivisht të promovohet dhe të informohet publiku mbi statusin adekuat të mbrojtjes sipas kërkesave ligjore dhe sjelljeve përkatëse
- C3) Të mbështetet aktivisht dhe të promovohet përgatitja e planeve të menaxhimit për Parkun Kombëtar dhe për të gjithë zonat e mbrojtura (p.sh. rezervatet strikte të natyrës, zonat e posaçme, - ZPM dhe ZPK, monumentet natyrore dhe peizazhet e mbrojtura) jashtë Parkut Kombëtar. Komuna aktivisht do të ushtrojë kompatibilitetin e planeve të menaxhimit me shfrytëzimin tradicional të tokës dhe me kërkesat e menaxhimit të peizazheve.
- C4) Përfshirë zonat e mbrojtura në konceptin e shëtitjes

D) Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm – turizmi rural

- D1) Të fuqizohet një departament për turizëm në administratën komunale
- D2) Të përgatitet një plan veprimi për eko-turizëm që përfshinë
 - i. Shënimin dhe rregullimin e shtigjeve të çiklizmit dhe të shëtitjes - renovimi dhe ndërtimi i shtëpive malore
 - ii. Inicijimi i aktiviteteve private që janë kompatible me qëllimet dhe kërkesat e zonave të mbrojtura dhe të PK; licencimi do të jetë i kufizuar në ato aktivitete që janë kompatible
 - iii. Të mbështetet zhvillimi i materialeve informative për turistët dhe për popullatën lokale – p.sh. programet shkollore
 - iv. Të zhvillohen mundësitë për çiklizëm malor me një koncept që nuk do të dëmton biodiversitetin dhe që nuk do të ketë ndikim negativ në asetet mjedisore
 - v. Të zhvillohet turizmi i gjuetisë dhe peshkimit për zonat jashtë Parkut Kombëtar
- D3) Të iniciohet njohja e Dragashit si një “Rezervat i Biosferës” zyrtar i UNESCO (UNESCO Programi Human dhe i Biosferë, 2012) në bashkëpunim me Qeverinë Kombëtare
- D4) Të zhvillohet një “Emër i Brendit” për rajonin e Dragashit dhe për mjedisin, dhe të promovohet shfrytëzimi i tij për prodhimet lokale

E) Programet për llojet e posaçme: gjueti, peshkim dhe të tjerë

- E1) Të bëhet shtimi i peshqive me specie të ndryshme vendore pa i dëmtuar ekosistemet e ujërave të freskëta
- E2) Të zhvillohet turizmi i gjuetisë dhe peshkimit në bashkëpunim me Asociacionin e Gjuetarëve për zonat jashtë Parkut Kombëtar. Kjo përfshinë:
 - i. Të vendoset mbi planet për gjueti të kafshëve të egra
 - ii. Arsimimi i gjuetarëve në nivel të duhur
 - iii. Të rregullohen dhe të jepen përgjegjësi dhe procedura të qarta në raste të ankesave dhe vërejtjeve:

Veprimet (të adaptuara nga Komuna e Dragashit (2010): Plani për Veprim Lokal mbi biodiversitetin në komunën e Dragashit (2011-2015)

- a. Prerja ilegale e druve
- b. Shkelja e kodeve dhe rregullave të gjuetisë dhe peshkimit

F) Planet, masat dhe zbatimi i rregulloreve për produktet pyjore jodrusore (mbledhja e kërpudhave dhe bimëve)

- F1) Të mbështeten autoritetet kompetente në shpalljen e zonave ku mbledhja e produkteve pyjore jodrusore (PPJD) është e lejuar për popullatën lokale
- F2) Të mbështeten autoritetet kompetente në themelimin e rregullave për mbledhje profesionale të PPJD (kodi i mirësjelljes, sasi të lejuara, periudhat e mbrojtjes etj.)
- F3) Të mbështeten autoritetet kompetente në themelimin dhe implementimin e kontrollit të kërkuar dhe mekanizmave të mbikëqyrjes

G) Të mbështeten dhe lehtësohen masat për mbrojtje të pyjeve (shih gjithashtu Strategjia Komunale e Pyjeve):

- G1) Paralajmërimi i hershëm i zjarreve dhe kontrolli
- G2) Ruajtja dhe restaurimi i pyjeve
- G3) Masat e pyllëzimit, përfshirë lehtësimin e materialit të fidanishteve

H) Parandalimi dhe kontrolli i ndotjes

- H1) Parandalimi i hedhjes ilegale të mbeturinave (ndotja e tokës) – mbeturinat e amvisnive dhe të ndërtimtarisë
- H2) Parandalimi apo ulja në popullsi që kontribuojnë në ndryshime klimatike
- H3) Zbatimi i pastrimit të mbeturinave në lumenj
- H4) Zëvendësimi i poçeve elektrike nga merkuri me ato me natrium

Aktivitete tjera mjedisore relevante që janë të përbëra në strategji tjera për:

Vendbanimet, Turizëm dhe Trashëgimi Kulturor, Bujqësi, Pylltari, Energji, Ujë dhe Kanalizim

3.4.2 Vendbanimet

Veprimet

A) Të procedohet me planifikimin urban:

- A1) Të hartohen planet për zhvillim urban (PZhU) dhe planet rregullatore të urbanizmit (PRrU) për qytetin e Dragashit dhe nënqendrat Blaç, Bellobrad, Bresanë, Brezne, Brod, Rapçë dhe Restelicë
- A2) Të hartohen planet rregullatore të urbanizmit për zona të ndërtimeve të mëdha siç është zona industriale në qytetin e Dragashit.

B) Të caktohen përgjegjësitë dhe procedurat për aplikim për leje të ndërtimit në bazë të ligjeve ekzistuese:

- B1) Të merren parasysh çështje të caktuara nëpërmjet planifikimit urban: dendësia mirë e rregulluar urbane dhe hapësira e hapur, cënueshmëria ndaj rreziqeve dhe katastrofave (ortekët, erozionet, vërshimet), makr-mikroklima (drita e diellit, era, vendet e ngrirjes), të dhëna mbi zonat e zhvillimit dhe parcelat kadastrale, rregullat e qasjes në ndërtesë (infrastruktura rrugore dhe instalime tjera), siguria dhe rendi publik, si dhe vlera historike dhe kulturore.
- B2) Të kontrollohen, mbikëqyren dhe inspektohen kushtet e ndërtimit (Ndërtesat janë të lejuara vetëm

zonat e caktuara nga PZhK/PZhU/PRrU dhe në bazë të rregulloreve të caktuara nga PRrU).

B3) Të sigurohet infrastrukturë fizike dhe sociale brenda zonës urbane.

C) Zhvillimi zonave për kolonitë komerciale dhe industriale:

C1) Qyteti i Dragashit dhe Shajnja: Të realizohet zhvillimi i një zone industriale në veri të qytetit të Dragashit (Vendimi i Kuvendit Komunal nga 2008: zona aktualisht është në ndërtim e sipër).

C2) Qyteti i Dragashit: Zgjerimi i zonës ekzistuese komerciale në jug të qytetit të Dragashit; të parandalohet ndërtimi i shtëpive private.

C3) Të verifikohet nevoja për koloni komerciale në nënqendra në Blaç, Bellobrad, Bresanë, Brezne dhe Restelicë; të përgatiten kushtet infrastrukturore për aktivitete potenciale të ndërtimeve private.

D) Zhvillimi i zonave të banimit:

D1) Të verifikohet nevoja për lagje banimi në fshatrat siç është propozuar në hartat e udhëzimit; të përgatiten kushtet infrastrukturore për aktivitetet potenciale të ndërtimit privat.

E) Rritja e qendrave të fshatrave:

E1) Të përmirësohen vlerat e komoditetit dhe dizajni urban i hapësirave publike qendrore në fshat si vende atraktive, duke përdorur elemente siç është shtrimi me gurë natyral, drunj, banka, fontana, etj.

F) Trashëgimia kulturore

F1) Të mbliidhen të dhëna sistematike mbi ndërtesat dhe arkitekturën tradicionale si dhe të vendeve dhe elementeve të jetës kulturore dhe fetare (siç janë varrezat, etj.)

F2) Të promovohet vlera e ndërtesave tradicionale si pjesë e trashëgimisë kulturore duke implementuar pilot projekte, p.sh. të gjindet përdorime të reja në ndërtesat e vjetra si qendra kulturore

F3) Të mbështeten pronarët privatë në ruajtjen dhe restaurimin e ndërtesave tradicionale duke ofruar ekspertizë teknike dhe fonde.

G) Të ruhen hapësirat e gjelbërta; të përmirësohen gjelbrimet në fshatra

G1) Të lëshohet një statut për mbrojtje nga rrëzimi të lisave të mëdhenj nëpër vendbanime

G2) Të promovohen pilot projektet e dizajnit të hapësirave të hapura (p.sh. tregu i gjelbërt apo sheshi te Kuvendi Komunal në qytetin e Dragashit)

G3) Ngritja e vetëdijes për mjedisin dhe sistemin e rripit të gjelbërt (të shënohen rripat e gjelbërt për t'i mbajtur të lirë nga ndërtimi)

H) Programet e uljes së rreziqeve për zonat e rrezikshme të shtëpive

H1) Të kryhet një analizë gjeologjike e rrezikut e kombinuar me një plan për ulje teknike të rrezikut për Restelicën.

H2) Të kryhet një program për ulje të rrezikut duke përfshirë: pyllëzimi në zonat relevante përreth Restelicës, ndërtimi i sistemeve të mbrojtjes teknike nga ortekët, nëse është e nevojshme të ndërmerren masa aktive për të zvogëluar rrezikun nga rrëshqitja e gurëve duke eliminuar zonat e rrezikshme, themelimin e një sistemi të monitorimit të rrezikut nga ortekët

3.4.3 Ekonomia lokale

Veprimet

A) Të themelohet një qeverisje e shëndoshë e sistemit ekonomik

A1) Të themelohet një bord komunal ndërdikasterial për zhvillim ekonomik dhe planifikim, duke përfshirë së

paku departamentin e bujqësisë, ekonomisë dhe të arsimit (punës?)

- A2) Të mbështeten Asociacionet e prodhuesve dhe të promovohen Asociacionet e reja (kur është e nevojshme) nga sektori i ekonomisë (bletarët, blegtorët, prodhuesit e qumështit, etj.) siç është përshkruar nga udhëzimet strategjike
- A3) Të promovohet krijimi i Forumeve sipas zinxhirit të vlerave (FORUMET E ZINXHIRIT TË VLERËS), me pjesëmarrjen e Asociacioneve të prodhuesve dhe tregëtarëve që lidhet në mënyrë adekuate me ta, me funksionet kryesore të:
- Vazhdimisht duke evoluuar udhëzimet strategjike,
 - Duke implementuar udhëzimet strategjike nëpërmjet menaxhimit në një mënyrë të integruar të tërë zinxhirit të vlerës (nga lënda e parë deri te konsumatori final),
 - supporting the creation of Consortia by value chain.
- A4) Të themelohet një FORUM KOMUNAL (FORUMK) për zhvillim ekonomik dhe planifikim - përfshirë komunën, përfaqësuesit e Forumeve të Zinxhirit të Vlerës dhe ekspertët - me detyrë të ndarjes së prioriteteve për strategjitë vjetore dhe shumëvjetore dhe planet lidhur me zhvillimin ekonomik. Këto udhëzime do të formësojnë sjelljet dhe veprimet e secilës pjesë në koherencë me atë se çka është themeluar nga FORUMK.
- A5) Të bëhen marrëveshje ndërkomunale të bashkëpunimit me komunat fqinje, me referencë specifike në sinergji posaçërisht lidhur me kënaqjen e nevojave për sigurim të lëndës së parë, duke ndarë rregullat, teknikat dhe praktikën e mira prodhuese, duke menaxhuar aktivitetet e marketingut dhe panairët, duke organizuar përbushjen e shërbimeve, duke siguruar certifikime të nevojshme dhe menaxhimin e kontrollit të kualitetit.
- A6) Të promovohet një Konferencë vjetore ku përfshihen Qeveria kombëtare dhe komunale për ndarje të planeve, për identifikim të linjave financiare dhe të implementohen bashkërisht projektet zhvillimore sipas Planit Zhvillimor Komunal.

B) Të përmirësohet performanca ekonomike dhe konkurrencësia

- B1) Të përmirësohet performanca e zinxhirëve të vlerës së bletëve, pyjeve, bimëve, mishit, qumështit nëpërmjet:
- i. Duke përmirësuar blokun e tyre prodhues,
 - ii. Duke menaxhuar futjen e inovacioneve kompatible dhe të qëndrueshme, me qëllim të ngritjes së shfrytëzimit të tyre të qëndrueshëm të përparësive të konkurrencës territoriale të nivelit të lartë që janë në pronësi të zonës së Dragashit, që deri më tani janë shfrytëzuar vetëm pak.
 - iii. Duke përmirësuar strategjitë e marketingut për ngritje të shitjes në nivel lokal, kombëtar dhe së paku rajonal (Gadishulli Ballkanik).
- B2) Për zinxhirin e vlerës së Tekstilit dhe Rrobave:
- i. Duke vlerësuar konkurrencën dhe pengesat e saj, dhe
 - ii. Duke elaboruar udhëzimet e detajshme strategjike.
- B3) Duke elaboruar strategjitë e nivelit të lartë në mënyrë që të ngritet dhe përmirësohet integrimi i FPD (Fruta, Perime dhe Drithëra) në sistemin prodhues të Dragashit
- B4) Duke përmirësuar efektshmërinë ekonomike dhe sociale të resurseve të turizmit në Dragash nëpërmjet institucionit të Sistemit Lokal të Turizmit i bazuar në ndërveprime ndërmjet nënsistemeve të Tërheqësve - Mikëpritjes - Shërbimeve - Prodhimeve të menaxhuara nga një nënsistem i Kontrollit.
- B5) Duke vlerësuar shanset dhe në mënyrë konsekuente duke elaboruar udhëzuesit strategjik për themelimin të një Sistemi Lokal Kulturor produktiv.

C) Të themelohet një sistem për të siguruar shërbime gjithëpërfshirëse

- C1) Të bëhet një marrëveshje ndërmjet komunës së Dragashit, komunave fqinje, shoqërisë civile dhe prodhuesve për organizimin e një partneriteti publiko-privat, i cili është në gjendje të menaxhojë dhe përbushë shërbime gjithëpërfshirëse për zhvillimin ekonomik, me prioritet në ringjalljen ekonomike (stimulimi i aktorëve lokal drejt valorizimit të resurseve lokale, stimulimi dhe mbështetja e rrjeteve dhe asociacioneve, sigurimin e informatave; qasja në financa (për kapitalizimin e bizneseve lokale, pa dënim

për njerëzit lokal); asistencë teknike (asistencë në përgatitjen e planeve të biznesit për qasje në banka dhe financa, për përmirësim të produktivitetit dhe konkurrencës, komercializim, higjienë të kafshëve, kontroll të kualitetit), trajnime profesionale, zhvillim të projektit; mbështetje për inovacione (përmirësim të kapaciteteve për identifikim dhe mbështetje të transferimit të teknologjive, si dhe praktikë inovative që janë në dispozicion në Kosovë apo jashtë vendit dhe favorizimi i transferit/adaptimit).

- C2) Ky sistem do të jetë i vetë-qëndrueshëm dhe do të përfshijë shërbimet ekzistuese si dhe shërbimet e nevojshme. Gjithashtu do të përfshijë një bord të menaxhimit të partneritetit (me përfaqësues të partnerëve lokal) dhe një strukturë me shkathtësi teknike.
- C3) Të sigurohet një periudhë e qëndrueshme për fillim të sistemit, duke financuar operimet e dy viteve të para, si dhe elaborimin e planit financiar pesë vjeçar.
- C4) Të themelohet një mekanizëm financiar, si një Fond Garantues, për të lehtësuar qasjen në financa për sipërmarrësit, popullatën dhe prodhuesit që kanë vështirësi t'i qasen kredive bankare.
- C5) Të përmirësohen kapacitetet e bordit menaxhues dhe struktura teknike

D) Të realizohet dizajnimi, implementimi dhe ngritja e fondeve për projektet me prioritet të infrastrukturës

Projektet në vijim kanë prioritet:

- D1) Hapësirat publike komunale për panaire dhe ngjarje të veçanta
- D2) Menaxhimi i mbeturinave
- D3) Laboratoret për kontroll të kualitetit
- D4) Qendra informative për turizëm
- D5) Ndërtimi i kapaciteteve apo zhvillimi i shkathtësive të nevojshme për zhvillimin e zinxhirit të vlerës

E) Të realizohet dhe implementohet një marketing efektiv territorial

- E1) Të definohet një personalitet komunal socio-ekonomik, duke identifikuar dhe sintetizuar karakteristikat kryesore nga pjesët territoriale të prekshme dhe të paprekshme, p.sh. pozita gjeografike dhe karakteri morfologjik, niveli i kapitalit social dhe i marrëdhënieve, sektori prodhues dhe karakteristikat e marketingut, intensiteti i këmbimeve të jashtme ekonomike dhe kulturore, trashëgimia kulturore, fryma e vendit, sistemi i vlerave sociale dhe qytetare, sistemi i shërbimeve, infrastruktura dhe niveli njohurisë për zhvillim social dhe ekonomik
- E2) Të definohet imazhi, të cilin aktorët lokal dëshirojnë ta japin brenda dhe jashtë territorit (mundësisht në bashkëpunim me komunat fqinje), dhe të krijohen ikonat-logot korresponduese
- E3) Të definohen instrumentet e komunikimit për shpërndarje më të mirë të profilit dhe të imazhit të territorit, duke filluar me rajonin e Ballkanit dhe me Evropën, për promovim dhe me qëllim të marketingut të produkteve-resurseve të saja dhe për të tërhequr resurset e jashtme.
- E4) Të përmirësohen shkathtësitë në teknologjinë e komunikimit dhe të informimit, nëpërmjet bashkëpunimit me një universitet për një program edukativ në fjalë.

3.4.4 Rrugët dhe transporti

Veprimet

Të iniciohen konsultime me autoritetet lokale dhe kombëtare nga Kosova, Shqipëria dhe IRJM lidhur me opsionet e përmirësimit të rrejtit rrugor tejkufitar.

Të koordinohet procesi i planifikimit për rrjetin rrugor, për shqyrtim të planeve të përgjithshme zhvillimore në të gjitha komunat. Të bëhen studime fizibiliteti transnacionale për projekte të tilla.

A) Rrjeti i rrugëve lokale:

A1) Të shtrohet rruga që lidhë fshatrat Leshtan dhe Radeshë

A2) Të shtrohet rruga që lidhë fshatin Lubovishtë me rrugën rajonale Dragash-kufi

A3) Të ndërtohet një rrugë e re lokale që lidhë Brodin dhe Restelicën; të elaborohet planifikimi për një rrugë të re ndërmjet Brodit dhe Zlipotokut; të renovohet rruga nga Zlipotoku deri në Dragash – në rrugën rajonale Restelicë

A4) Të ndërtohet një rrugë tranzitore për në Brrut dhe Zgatar

B) Rrjeti i rrugëve rajonale:

B 1) Të zgjerohet rruga ekzistuese rajonale (Dragash – Prizren nëpër Zhur); të përmirësohet shpejtësia dhe siguria e udhëtimit me anë të zgjerimit të pjesëshëm në tri korsi dhe përmirësimi i pjesëshëm në rreshtim

B 2) Të zgjerohet rruga ekzistuese rajonale Dragash – Brod në dy korsi

B 3) Të ndërtohet qasja e dytë rrugore ndërmjet Dragashit dhe Prizrenit nëpër Zaplluxhe dhe Lez duke përmirësuar dhe shtruar rrugën ekzistuese me zhavorr.

B 4) Të elaborohet planifikimi dhe të ndërtohet një rrugë tranzitore për Restelicë

B 5) Të ndërtohet një rrugë e re që lidhë Brodin dhe Restelicën: të elaborohet një planifikim i ri për një rrugë të re në jug të Brodit për në Restelicë përgjatë shtigjeve tradicionale.

C) Lidhjet tejkufitare:

C 1) Të krijohet një lidhje tejkufitare afër Orçushës duke e shtruar rrugën ekzistuese për në Orçushë dhe duke ndërtuar lidhjen rrugore që mungon me stacionin ekzistues kufitar në kufirin me Shqipërinë.

C 2) Të shtrohet rruga ekzistuese nga Krusheva për në stacionin ekzistues kufitar në kufirin me Shqipërinë.

C 3) Të shtrohet rruga ekzistuese e zhavorrit nga Restelica për në kufi me IRJM.

C 4) Të vlerësohet fizibiliteti i një lidhjeje tejkufitare nga rruga rajonale Dragash – Prizren përgjatë linit Pllavë për në kufirin me Shqipërinë, duke shfrytëzuar lartësinë mbidetare të ultë prej vetëm 800 – 900m (lidhja rajonale potencialisht e rëndësishme me autostradën ndërkombëtare).

D) Lidhja rrugore bujqësore:

D 1) Të zgjerohen rrugët lokale/shtigjet deri te tokat e punueshme me qëllim që bujqësia dhe dhe shfrytëzimi i tokës të bëhen në mënyrë më efikase

E) Mirëmbajtja:

E 1) Të krijohet një njësi në administratën komunale që do të jetë përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrugëve dhe të sigurohet se do të ketë buxhet dhe ekspertizë teknike për të përmbushur këtë detyrë me kujdes.

E 2) Të monitorohet rregullisht situata në rrugë; të ndërmerren punime të meremetimit porsa të jetë e

nevojshme me qëllim të evitimit të dëmtimeve më të mëdha.

F) Transporti publik

F 1) Të përmirësohet shpeshësia dhe orari i autobusuëve publik me një koordinim nëpërmjet komunës.

F 2) Të përmirësohet lidhja me transportin publik posaçërisht në rajonin e Gorës, të mbështeten transportet ekzistuese të përbashkëta duke krijuar një sistem të rezervimit me anë të internetit për udhëtimet e përbashkëta në relacionin Dragash-Restelicë dhe Dragash-Brod. (kjo gjithashtu mund të shfrytëzohet edhe nga turistët)

F 3) Të ndërtohen stacione të autobusëve dhe streha në vend-ndaljet e rëndësishme (në Dragash, te udhëkryqi Dragash-Prizren / Dragash-Zaplluxhe, ...)

G) Projektet rrugore që nuk duhet të realizohen: (shih më poshtë arsyet)

G1) Projekti rrugor për një lidhje tejkufitare nga Brodi për në IRJM, që kalon nga liqeni Shutman

G2) Projekti rrugor për një lidhje tejkufitare nga Zaplluxhja drejt kufirit me IRJM (te Mali Skarpa në një lartësi mbidetare prej 2474m)

G3) Projekti për një rrugë prej kufirit në kufi, nga kufiri i Shqipërisë afër Krushevës (stacioni ekzistues kufitar) në kufirin me IRJM në jug të Restelicës (rreshtim i ri pa i shfrytëzuar rrugët ekzistuese, që kalon në perëndim të Restelicës në një lartësi më të madhe mbidetare)

3.4.5 Shëndetësi dhe mbrojtje civile

Veprimet

A) Të përshtatet distribuimi hapësinor i njësive të kujdesit shëndetësor

- A1) Të avancohet ambulanta në Brod në Qendër të Mjekësisë Familjare; të sigurohet infrastrukturë adekuate.
- A2) Të avancohet ambulanta në Restelicë në Qendër të Mjekësisë Familjare; të sigurohet infrastrukturë adekuate.
- A3) Të disavancohet Qendra e Mjekësisë Familjare në Krushevë në ambulante; të transferohet infrastruktura në Restelicë.
- A4) Të hapen barnatore në nënqendra në Blaç, Brod dhe Restelicë.

B) Të rritet numri i stafit

- B1) Të sigurohet ekzistenca e më së paku 1 mjeku, 1 infermier, 1 mami dhe 1 teknik i stomatologjisë në çdo Qendër të Mjekësisë Familjare (stafi shtesë mund të jetë sipas numrit të banorëve në zonën e mbulimit)
- B2) Punësimi i gjinekologëve shtesë (preferohen gra).

C) Të përmirësohet performanca e stafit mjekësor

- C1) Trajnime freskuese profesionale të rregullta për stafin.
- C2) Të ngritet motivimi i stafit.

D) Përmirësimi i infrastrukturës

- D1) Përmirësimi i përgjithshëm i pajisjeve fizike dhe teknike për të realizuar standardet moderne.
- D2) Përmirësimi i efijencës së energjisë dhe i furnizimit me ujë të nxehtë me anë të shfrytëzimit të nxemjes solare të të ujit.
- D3) Bartjen e urgjencës në Dragash në katin e parë.

E) Shërbimet shtesë shëndetësore

- E1) Të instalohet një shërbim mobil shëndetësor, i përbërë nga një mjek dhe infermier si dhe me pajisje bazike, për të vizituar fshatrat e thella së paku dy herë në muaj
- E2) Organizimi i transportit të sigurt të pacientëve të emergjencës për në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Dragash
- E3) Të organizohet transporti i rregull i pacientëve me sëmundje të veçanta nga shtëpia për në Prizren
- E4) Të futen temat e higjienës dhe të shëndetësisë në planprogramet shkollore (poasçërisht në nivelin e shkollës fillore)
- E5) Të organizohen projekte për informimin e të rriturve lidhur me sëmundjet aktuale, sanitet dhe higjienë, si dhe për edukimin mbi ushqimin.
- E6) Digitalizimi i Sistemit Informativ Shëndetësor.
- E7) Të instalohet një uebfaqe e mirëmbajtur në dy gjuhë lidhur me sëmundjet aktuale dhe kujdesin shëndetësor.
- E8) Të rriten fondet për shëndetësi dhe të mbështetet procesi i vendimmarrjes e bazuar në dëshmi.

F) Mbrojtja civile

- F1) Të vendosen pajisje bazike të fikjes së zjarrit në çdo nënqendër (Blaç, Bellobrad, Bresanë, Brezne, Brod, Rapçë dhe Restelicë)
- F2) Të edukohen brigada vullnetare të zjarrfikësve në çdo nënqendër
- F3) Të kryhen trajnime të në mesin e qytetarëve mbi fikjen e zjarrit dhe parandalimin e zjarreve.

3.4.6 Arsimi

Veprimet

A) Sistemi (serb) paralel i shkollave

- A1) Të integrohen mësuesit e sistemit serb në sistemin e Kosovës.
- A2) Të motivohet një diskutim brenda shoqërisë civile mbi integrimin e sistemit (serb) paralel në sistemin kosovar; Të bisedohet poasçërisht me prindërit e fëmijëve që ndjekin shkollën serbe.
- A3) Të motivohen aktivitetet këmbimore ndërmjet të dy komuniteteve.
- A4) Të zgjerohet sistemi shkollor i Kosovës në rajonin e Gorës (poasçërisht në Restelicë)

B) Shkollimi i mesëm

- B1) Të hapet shkolla e re e mesme/profesionale në qytetin e Dragashit.
- B2) Të shtohet numri i nxënësve në shkollën e mesme dhe në universitet (djem dhe vajza) dhe të sigurohet se shënimet mbi ndjekjen e mësimin të ndahen sipas gjinisë.
- B3) Të themelohen klasa satelite të shkollës së mesme në rajonin e Gorës (Restelicë, Brod).

C) Të mësuarit gjatë gjithë jetës

- C1) Të hapet shkolla e re e mesme/profesionale në qytetin e Dragashit si një qendër e arsimimit për të rriturit për të rinjtë mbi 15 vjeç.
- C2) Të realizohen programe të arsimimit për të rritur për burra, gra, për të papunët dhe për të rriturit me kualifikime të ulëta; tërheqja e mjeteve shtesë financiare dhe të organizohen specialistët për të mbajtur kurset për arsimim të të rriturve.
- C3) Të realizohen trajnime të punës në fushat kryesore të zhvillimit ekonomik (bujqësi, pylltari, mbledhje të bimëve, përpunim të ushqimit, kulturë dhe turizëm).
- C4) Të ofrohen mundësi për komunitetet lokale për të vepruar dhe për të marrë pjesë në strategjitë ekonomike, nëpërmjet trajnimeve në planifikim të biznesit, menaxhim, mikëpritje dhe ofrim të shërbimeve, kontabilitet dhe marketing.
- C5) Të aktivizohen mundësi të barabarta për gratë që të kenë qasje në këto mundësi, me trajnime të synuara. Projektet duhet të fokusohen në ndërtimin e shkathtësive dhe të kapitalit social të grave për të marrë pjesë aktivisht në aktivitetet tradicionale të përgatitjes së ushqimit, ofrim të akomodimit, bujqësi dhe përpunim të produkteve bujqësore, prodhimin e veshjeve dhe të tekstit, në lidhje me turizëm si

dhe mundësi të tjera të gjenerimit të të hyrave.

D) Të optimizohet arsimi fillor

- D1) Riorganizimi i mësuesve, nuk ka nevojë për klasat (për shkak të numrit të vogël të nxënësve).
- D2) Nëse transporti për në shkollat tjera fillore është i aranzhuar, të mbyllet shkollat fillore me më pak se 10 nxënës.

E) Procesi arsimor

- E1) Të përkushtohen mësuesit për trajnime të rregullta profesionale rifreskuese.
- E2) Të organizohen konferenca mësues-prindër; të mundësohet angazhimi aktiv i prindërve në procesin arsimor (ditët e aksionit për mjedisin, për ruajtjen e traditave/trashëgimisë kulturore, etj.).
- E3) Këmbim i përvojave dhe njohurive me shkollat tjera në Kosovë dhe jashtë vendit.
- E4) Të integrohen fëmijët me nevoja të veçanta në arsimin e përgjithshëm.

F) Të përmirësohet infrastruktura dhe kushtet e mëtejme

- F1) Përmirësimi infrastrukturës së shkollës (ndërtesat, fushat e sportit, laboratorët, teknologjia, materiali mësimor, etj.).
- F2) Të rregullohet transporti shkollor për në shkollën e mesme dhe për në shkollë të mesme ku është e nevojshme.
- F3) Mbështetja financiare (bursa, transport, libra).

G) Të zhvillohen fusha të reja

- G1) Të themelohet një institucion parashkollor (qerdhe, klasa parashkollore dhe qendra komunitare).
- G2) Të përfshihen çështjet aktuale në planprogramet shkollore (mbi shëndetësinë, trashëgiminë kulturore, energjinë, mjedisin dhe grumbullimin e mbeturinave).
- G3) Të integrohet teknologjia moderne (kompjuterë, internet) në jetën shkollore (gjithashtu të menaxhohet problemi i fshatrave të shpërndara).

3.4.7 Turizmi dhe trashëgimia kulturore

Veprimet

A) Të mbështetet zhvillimi i turizmit / Të stimulohet turizmi potencial

- A1) Të zhvillohet një Plan Veprimi për të implementuar Strategjinë e Turizmit të Bazuar në Natyrë dhe të inkorporohet turizmi kulturor.
- A2) Të shfrytëzohet themelimi i Parkut Kombëtar për të krijuar një Qendër të vizitorëve dhe mundësisht edhe objekte tjera në interes të turizmit.
- A3) Të zhvillohet dhe ngritet standardi i infrastrukturës teknike (ujë, kanalizim, menaxhim i mbeturinave)
- A4) Të angazhohet një zyrtar i veçantë për turizëm në kuadër të administratës komunale (p.sh. në kuadër të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim)
- A5) Largimi i deponisë së Prizrenit në hyrje të Dragashit dhe i deponive tjera ilegale
- A6) Të ndërmerren programe të ngritjes së vetëdijes në dobi të një mjedisi më të pastër duke synuar zvogëlimin e hedhjes së mbeturinave nëpër rrugë apo lumenj
- A7) Të themelohet partneritet ndërkomunal dhe të përfitohet nga precedentet, leksionet e mësuara dhe përvojat nga projektet dhe komunat tjera në Kosovë
- A8) Trajnime për mikëpritje, shërbime dhe kualitet si dhe trajnime për udhëzues për shëtitje për qytetarët e Dragashit
- A9) Të inkurajohet partneritetit publiko-privat për të ngritur investimet në sektorin e turizmit
- A10) Marketingu i Dragashit në turizmin rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar (p.sh. me kartë postale, broshura, libra mbi Dragashin dhe në internet)
- A11) Të krijohet një uebfaqe që ua mundëson vizitorëve të planifikojnë udhëtimet e tyre para se të arrijnë dhe përfundimisht të bëjnë rezervimet me akomodim dhe mëngjes

A12) Të shtohet rrjeti rrugor duke pasur parasysh se disa rrugë përreth ndërtesave të trashëgimisë / disa pjesë duhet ta ruajnë formën tradicionale të ndërtimit / materialeve

B) Të eksploroheh disa fusha (të reja) të turizmit

- B1) Vlerësime të Sigurta të Ndikimit Mjedisor për infrastrukturën e skijimit, p.sh. në majë të malit afër Brodit apo Zaplluxhes
- B2) Të kryhet studimi i fizibilitetit për turizmin e skijimit në kodrat afër Pllajnikut
- B3) Të vlerësohen mundësitë për peshkim, lundrim dhe aktivitete tjera në ujë; si dhe çiklizmi malor, alpinizmi dhe aktivitete tjera në natyrë.
- B4) Të inkorporohen turizmi kulturor në Strategjinë e Turizmit të Bazuar në Natyrë dhe të eksploroheh festivalet tradicionale etj. për turizëm
- B5) Zhvillimi i turizmit të gjuetisë në baskëpunim me Shoqatën e Gjuetarëve për zonat jashtë Parkut Kombëtar
 - i. Vendimet mbi planet për gjueti të kafshëve të egra
 - ii. Edukimi i gjuetarëve në nivelin e duhur
 - iii. Të rregullohet dhe të jepen përgjegjësi dhe procedurat të qarta në raste të ankesave dhe vërejtjeve mbi
 - a. Prerjet ilegale të druve
 - b. Kur kodri i peshkimit apo gjuetisë dhe rregullat shkilen

C) Të krijohen qendrat turistike në Dragash

- C1) Të bëhet Dragashi “bazë e kampit turistik” duke përfshirë zyrën e turizmit/pika për informatat turistike për të ofruar informata praktike për vizitorët dhe për të ndihmuar që të organizohen akomodimi, transporti dhe udhëheqësit, akomodimet (hotel)
- C2) Të bëhet Bellobradi një “qendër turistike” duke qenë edhe si pikënisje për ecje, çiklizëm, udhëtime, etj. në luginën e Opojës
- C3) Të bëhet Bresana një “qendër turistike” duke qenë edhe si pikënisje për ecje, çiklizëm, udhëtime, etj. në luginën e Opojës
- C4) Të bëhet Brezna një “qendër turistike” duke qenë si pikënisje për ecje, piknik, etj. te liqeni i Breznës; akomodim (hotel, shtëpi pushimi)
- C5) Të bëhet Zaplluxhja një “qendër turistike” duke qenë si një pikënisje për ecje, çiklizëm, udhëtime, etj. në luginën e Opojës; për shëtitje, piknik, etj. në Malet e Sharrit; pikë e lidhjes ndërkombëtare për shëtitje jashtë vendit; zonë skijimi; akomodim (hotel, shtëpi pushimi)
- C6) Të bëhet Brodi një “qendër turistike” duke qenë si një pikënisje për shëtitje, piknik, etj. në malet e Gorës; akomodim (hotel “Arxhena”, shtëpi pushimi, mundësisht vend kampimi); zonë e skijimit; pikë e lidhjes ndërkombëtare për shëtitje jashtë vendit
- C7) Të bëhet Rapça një “qendër turistike” duke qenë si një pikë e nisjes për shëtitjet në Malin Koritnik; pikë e lidhjes ndërkombëtare për shëtitje jashtë vendit
- C8) Të bëhet Radesha një “qendër turistike” duke qenë si një pikë nisje për shëtitjet në malet e Gorës dhe në luginën e Opojës; akomodim (hotel, shtëpi pushimi)
- C9) Të bëhet Restelica një “qendër turistike” duke qenë si një pikë e nisjes për shëtitje; pikë e lidhjes ndërkombëtare për shëtitje jashtë vendit; mundësisht si një vend për një “qendër e vizitorëve të Parkut Kombëtar”

D) Të përmirësohet sistemi i shtigjeve të shëtitjes

- D1) Identifikimi dhe vendsja e shenjave të ecjes/shëtitjes
- D2) Mirëmbajtja e shtigjeve
- D3) Krijimi i hartave, strategjisë së marketingut
- D4) Të zhvillohet hierarkia e itinerarëve, ushqim për një spektër të gjerë të vizitorëve (siç janë familjet me fëmijë, personat me aftësi të kufizuara, ekspertët e shëtitjes dhe të alpinizimit, turistët kulturor). Ecjet me lake janë më të preferuara. Kjo mund t'i lidhë edhe grupet e fshatrave, mund të kalojë përreth vendeve me interes kulturor dhe natyror dhe/ose të përcjellë shtigjet tradicionale.
- D5) Pajisje dhe infrastrukturë tjetër turistike siç janë toaletët/banjot, pika të freskimit, shenja, harta statike,

tabela të piknikut, shporta të mbeturinave, shenja për informim, gardhe, etj. mund të jenë të nevojshme për të siguruar rehati dhe siguri përgjatë shtigjeve në natyrë si dhe të sigurohet mbrojtja e mjedisit dhe gjetja e rrugës.

E) Bashkëpunimi ndërmjet turizmit dhe trashëgimisë kulturore/natyrore

- E1) Të themelohet një muze etnologjik në Dragash
- E2) Të përqendrohen përpjekjet në themelimin e Parkut Kombëtar
- E3) Të bëhen projekte që janë të fokusuar në turizëm të “autenticitetit sipas vendit”, të ndërtohen shkathtësi dhe kapital social posaçërisht të grave për të marrë pjesë aktivisht në aktivitetet e lidhura me turizëm (p.sh. aktivitetet tradicionale të përgatitjes së ushqimit, duke ofruar akomodim, bujqësi dhe përpunim të prodhimeve bujqësore dhe prodhimi i veshjeve dhe tekstilit)
- E4) Të renovohen lagjet ekzistuese të ndërtesave tradicionale dhe të shndërrohen në akomodime për vizitorët. Të bëhen ato si “pikë fokale e vizitorëve” në pika të ndryshme në komunë nga ku asetet natyrore dhe kulturore mund të eksplorojnë, të shikohen në historinë e lëvizjeve nëpër tërë komunën
- E5) Të kthehen mullinjët në objekte të dobishme turistike (p.sh. pika të ekzpozitave historike të fshatit, mjete mikëpritëse), dhe të mirëmbahen ato si peizazhe kulturore (p.sh. përfshirë lumenjtë përreht/masat e mbojtjes së pyjeve)
- E6) Të shqyrtohet koncepti i themelimit të një muzeu në natyrë në Zlipotok

F) Ngritja e vetëdijes mbi trashëgiminë kulturore

- F1) Programet e ngritjes së vetëdijes brenda komuniteteve dhe me qytetarët mbi trajtimin e drejtë të trashëgimisë kulturore (p.sh. çka të bëhet nëse zbulohen gjetje arkeologjike, çfarë ‘trashëgimie’ është, etj.) për të garantuar respekt dhe mbrojtje
- F2) Formimi i grupeve punuese për trashëgimi kulturore/natyrore dhe turizëm, të përbëra nga Goranë dhe Shqiptarë, përfshirë gratë dhe të rinjtë
- F3) Të përfshihet tema e trashëgimisë/traditës kulturore në planprogramet mësimore dhe të organizohen aktivitete këmbimi ndërmjet komuniteteve të goranëve dhe të shqiptarëve
- F4) Trajnimi i stafit komunal nga sektore të ndryshme që kanë të bëjnë me asetet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, vlerat, çështjet të cilat i hasin gjatë mbrojtjes dhe metodologjitë për të siguruar ruajtjen e tyre

G) Të mirëmbahet trashëgimia kulturore

- G1) Punët e konservimit emergjent për të gjitha vendet nën Mbrojtje Kombëtare apo Mbrojtje të Përkohshme Kombëtare, hulumtimet tjera në pritje që do të ndihmojnë definimin e strategjisë së konservimit.
- G2) Shënimi i varrezave, mullinjve, vendeve fetare dhe monumenteve si asetet e trashëgimisë kulturore
- G3) Themelimi i trajnimeve profesionale mbi teknikat e konstruktimit të trashëgimisë, zejtaria tradicionale, mjeshtëria dhe punëdoret dhe proceset tjera të trashëgimisë së paprekshme.
- G4) Shfrytëzimi i ndërtesave të trashëgimisë si vende për festim, festivale dhe ngjarje të tjera të komunitetit dhe/ose konvertimi për shfrytëzime të reja në pajtim me këshillat e trashëgimisë profesionale/konservimit.

H) Hulumtimi ekzekutiv i trashëgimisë kombëtare

- H1) Të përpilohet inventari i trashëgimisë kulturore në Dragash: verifikimi i fakteve, kryerja e hulumtimeve të reja, kompletimi i seksioneve mbi peizazhet kulturore, trashëgimia e luajtshme dhe trashëgimia e paprekshme.
- H2) Të mundësohet hulumtimi profesional në zonat arkeologjike (dhe në ndonjë vend tjetër të “ish vendbanimeve” që mund të zbulohen në ndërkohë) dhe hulumtimet profesionale dhe angazhimi i komunitetit me qëllim të përpilimit të një databaze të artefakteve arkeologjike
- H3) Të mundësohet hulumtimi nga profesionistët në bashkëpunim me institucionet lokale dhe kombëtare për një klasifikim final të Zonave Arkitekturore për Konservim
- H4) Të mundësohet hulumtim me anë të metodave të pjesëmarrjes për regjistrim dhe ruajtje të trashëgimisë së paprekshme
- H5) Mbledhja e informatave më komplete mbi ‘rrëfimet kulturore’, për shembull, lidhur me resurset e

bollshme të ujit të Dragashit, rrugët historike tregëtare dhe lidhjet ndërkombëtare, peizazhe të shoqëruara me legjenda dhe tregime, dhe zhvillimi dhe prodhimi i veshjeve tradicionale.

3.4.8 Bujqësi

Veprimet

A) Të përmirësohet performanca ekonomike dhe konkurrentësia e zinxhirëve të vlerës me fokus në

- Mish (fokusi në racat e vogla lokale të gjedhave, deleve dhe dhive)
- Qumësht dhe produkte të qumështit
- Patate (posaçërisht patatet për farë),
- Fruta dhe fruta të imëta dhe kultivimet e veçanta (bimët)

nëpërmjet

A1) Përmirësimi të bllokut të prodhimit

A2) Trajnimeve profesionale mbi teknikat moderne të prodhimit, marketingut dhe kontrollit të kualitetit/nivelet të certifikimit

A3) Përmirësimi të strategjive të marketingut për ngritje të shitjes në nivel lokal, kombëtar dhe së paku në nivel rajonal (Ballkan) (shih gjithashtu B3).

B) Të zhvillohet bashkërisht me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) dhe me Drejtorinë e Parkut Kombëtar si në vijim:

B1) Të lehtësohet mbështetja e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR) (për shembull me *“Programin mbi Mbështetjen Direkte të Bujqësisë 2012”*)

B2) Sistemi i menaxhimit të kullosave të përmirësojë rendimentin dhe të ruaj ekosistemet malore

B3) Të krijohen objekte për procesin e certifikimit sipas standardeve ndërkombëtare

B4) Të krijohet një “emër i brendit” për rajonin e Dragashit dhe për mjedisin e tij dhe të promovohet shfrytëzimi i tij për produktet lokale

C) Të elaborohen nivele më të larta të strategjisë për të ngritur dhe përmirësuar integrimin e produkteve lokale

C1) Për: FPD (Fruta, Perime dhe Drithëra) në sistemin e prodhimit në Dragash

C2) Të mbështetet Qeveria Kombëtare në nisjen e një procesi për njohje të Dragashit si një “Rezervat i Biosferës” zyrtar i UNESCO (UNESCO Programi Human dhe i Biosferës, 2012)

3.4.9 Pylltari

Veprimet

A) Të përmirësohet struktura pyjore

A1) Të aplikohet dhe të shtohet rrallimi i pyjeve cungishte të dominuara nga pyjet e ahut dhe nga llojet tjera gjethëgjera në një shkallë më të gjerë, duke aplikuar intervalet e duhura të prerjes dhe të mbillen drunj të ri aty ku kërkohet.

A2) Të mundësohet komuniteteve mundësia e prerjes së druve të zjarrit nën kontroll të Agjencisë së Pyjeve të Kosovës dhe të sektorit komunal për pyje, me anë të rojeve të pyllit, të cilët do të jenë përgjegjës për një zonë të posaçme të pyjeve dhe ku çdo qark pyjor në komunë ka rojet e veta. Kjo mund të ndihmojë për të mirëmbajtur pyjet dhe për të siguruar resurset për komunitetin.

A3) Të përgatitet një plan i pyllëzimit për komunën në bashkëpunim të ngushtë me fshatrat, APK dhe me Drejtorinë e Parkut Kombëtar.

- A4) Të mbështetet themelimi i fidanishteve lokale për riprodhim të populacioneve të kualitetit të lartë për rimbjellje dhe pyllëzim.
- A5) Të mbillen lloje vendore në zonat që janë lënë të pashfrytëzuara për shkak të produktivitetit të ultë në lartësi mbidetare më të ultë se 1500m dhe me një fokus në zonat e prirura për katastrofa (erozion, ortekë dhe rrëshqitje e tokës)
- A6) Të fillohet dhe/ose të mbështetet procesi i certifikimit i pyjeve me produktivitet të lartë sipas standardeve të KKP të Kosovës. Të sigurohet menaxhimi i pyjeve të vjetra në harmoni me standardet e KKP.
- A7) Të shtohet prerja në pyjet e larta nëse mund të sigurohen praktika të menaxhimit të mirë të pyjeve. Kjo mund të përmirësojë pyjet dhe produktivitetin e tyre në të ardhmen dhe të prodhohet dru teknik për ngritje të të hyrave për buxhetin e komunës
- A8) Të krijohen mekanizma të paralajmërimit të hershëm për zjarret.
- A9) Të përmirësohen kualifikimet shkathtësitë e kontrollit të rojeve të pyllit (përfshirë aktivitetet e prerjeve ilegale).

B) Të përmirësohen strukturat administrative

- B1) Të forcohet roli i zyrtarëve të pylltarisë në “Drejtorinë Komunale të Bujqësisë, Turizmit, Zhvillimit Rural dhe Inspektionit”.
- B2) Të mbështetet bashkëpunimi i ngushtë i zyrtarëve komunal të pylltarisë, zyrtarit për konservim të natyrës dhe të sektorit për turizëm (zyrtari për zhvillim të turizmit).

C) Të përmirësohet vetëdijësimi

- C1) Të përgatiten fushata të vetëdijësimit që theksojnë ndikimet negative dhe rreziqet për pyje dhe biodiversitet nga zjarret e pyjeve.
- C2) Të diskutohen planet vjetore me komunitetin, për të inkuorporuar nevojat e tyre dhe të integrohen ato në porcesin e planifikimit.
- C3) Të hulumtohen opsionet për shfrytëzimin e druve halor për teknologjitë e reja të nxemjes (peleta etc.).

D) Programet e trajnimit

- D1) Trajnime dhe ushtrime mbi paralajmërimin e hershëm për zjarret dhe fikjen e zjarreve të pyjeve.
- D2) Trajnimi i rojeve të pyjeve.
- D3) Praktikant e menaxhimit për pronarët e pyjeve private (posaçërisht menaxhimi i pyjeve cungishte).

3.4.10 Energjia

Veprimet

A) Të integrohet Komuna në Strategjinë për Energji të Kosovës

- A1) Të themelohet Zyra Komunale e Energjisë (ZKE) – përgjegjëse për planifikim të zhvillimit të energjisë, mbikëqyrja e kontrollit teknik dhe i shërbimeve, etj.
- A2) Të zhvillohet Strategjia për Energji e Komunës së Dragashit (SEKD), Plani Komunal për Veprim për Energji (PKVE) dhe Plani Komunal për Eficiencë të Energjisë (PKEE)
- A3) Të angazhohen banorët e komunës së Dragashit nëpërmjet Grupeve Punuese Komunale dhe Grupeve Punuese të Fshatrave
- A4) Të implementohet Strategjia për Energji në bashkëpunim të ngushtë me sektorin privat
- A5) Bashkëpunimi ndërmjet ZKE me Agjencitë Donatore Ndërkombëtare në të gjitha intervenimet lidhur me energji

B) Të mbështetet privatizimi i gjenerimit të energjisë elektrike nën 10 MW (hidrocentrale dhe me erë) në bashkëpunim me Zyrën e Rregullatorit për Energji

- B1) T’u ofrohet kompanive private apo konsorciumeve investimi, instalimi dhe operimi i centraleve elektrike

me një gjenerim nominal nën 10 MW

B2) Të sigurohen stimulime për investime private në Teknologji të Energjisë së Ripërtërishme (TER)- Hidrocentralet e vogla (HCV), Konvertorët e Energjisë me Erë (KEE) si dhe shfrytëzimi i biomasës (p.sh. gasifikimi) - që ndjekë disa direktiva përkatëse të Bashkësisë Evropiane/Komisionit Evropian dhe të shmangen ndikimet negative në mjedis, përfshirë shkaktimin e dëmit në habitatet e lumenjve dhe biodiversitet.

B3) Të përkushtohen investuesit privat dhe kompanitë/konsorciumet për vëzhgim të kualitetit ndërkombëtar dhe dhe standardeve mjedisore gjatë ndërtimit dhe operimit të hidrocentraleve të tilla në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRÉ).

C) Analiza e kërkesës/furnizimit dhe gjenerim të kapaciteteve shtesë për komunën e Dragashit

C1) Të përditësohen të dhënat ekzistuese për të vlerësuar kërkesën dhe furnizimin e energjisë elektrike në të ardhmen

C2) Të vlerësohet kapacitetit i mëtejshëm i gjenerimit të energjisë elektrike në kufijtë e komunës së Dragashit bazuar në studimet për potencialet e hidrocentraleve, rrezatimit diellor, energjisë së erës, burimeve të biomasës dhe potencialit gjeotermal

C3) Studime të posaçme mbi potencialin e erës dhe të rrezatimit diellor përfshirë vlerësimin e mundshëm të vendit për centralet elektrike të bazuara në TER brenda kufijve të Dragashit do të kryhet në bashkëpunim me MEZh dhe të financohet për shembull nga agjencitë donatore dhe të formohet databaza për propozimet për instalimet shtesë për gjenerim të energjisë në Komunë.

D) Plani komunal për aplikimet diellore të nxemjes

D1) Të kryhet një analizë e potencialit për sistemet diellore të nxemjes (STN) për sektorin publik dhe privat (spitale, barnatore, shkolla, xhami, stacion policor, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe shtëpitë private)

D2) Të fillohen seminare për vetëdijësim për shfrytëzuesit potencial privat dhe komercial mbi përfitimet e kostos së STN, operimi i tyre dhe mirëmbajtja

D3) Të fillohet zhvillimi i kapaciteteve dhe trajnimi për sipërmarrësit lokal siç janë hidraulikët, instaluesit e gypave sanitar dhe filterëve të gypave

D4) Të hulumtohen mundësitë e skemave të financimit për investime private në STN përfshirë opsionet për kredi të buta në bashkëpunim me MEZh

E) Plani komunal për efikasitet të energjisë dhe strategji për menaxhimin e kërkesës

E1) Të futen pajisjet me Efikasitet të Energjisë në sektorin publik, sektorin komercial dhe në shtëpi

E2) Menaxhimi i kërkesës lidhur me shmangien e ngakesave elektrike maksimale duke caktuar orar të shfrytëzimit të rrymës, kështu që ngakesat maksimale të minimizohen

E3) Të përmirësohet efikasiteti e energjisë termale me anë të izolimeve të mureve, kulmeve dhe dritare me humbje minimale të nxehtësisë

E4) Të përmirësohet efikasiteti e energjisë në dritat e rrugëve të komunës dhe të instalohen drita shtesë me teknologji EE në tërë fshatrat.

E5) Stimulime dhe ngritje të vetëdijes për grupet e shfrytëzuesve përfshirë vendimmarrësit e sektorit publik, shfrytëzuesit lokal komercial (pronarët e dyqaneve, restorantet, kafenetë, etj.), stafi lokal i NVMve, (elektricitet, hidraulik, instalues të gypave, etj.) si dhe qytetarët përfshirë edhe nxënësit e shkollave publike

E6) Të nisët ndërtimi i kapaciteteve dhe i trajnimeve profesionale për shfrytëzuesit lokal përfshirë vendimmarrësit e sektorit publik, shfrytëzuesit lokal komercial, stafin lokal të NVMve si dhe qytetarët, përfshirë nxënësit e shkollave publike

3.4.11 Menaxhimi i furnizimit me ujë dhe i ujërave të zeza

Veprimet

A) Përmirësimi i sistemit të ujësjellësit dhe ujërave të zeza

- A1) Zgjerimi i planit për ujë dhe ujëra të zeza (Masterplani) në detaje për të rehabilituar objektet e infrastrukturës ekzistuese
- A2) Zjgerimi i sistemeve ekzistuese operative në tërë fshatrat
- A3) Të ndërmerren masa për trajtim të duhur të ujit sipas madhësisë së fshatrave dhe numrit të përfituesve (furnizim i ujit me gypa dhe trajtimi i ujërave të zeza; rrjeti i kanalizimit dhe trajtimi biologjik, etj.)
- A4) Të krijohen njësi të përhershme të shërbimeve për mirëmbajtje parandaluese dhe riparim në çdo fshat

B) Informimi dhe trajnimi

- B1) Implementimi i një fushate të vetëdijësimit për të bindur popullatën mbi nevojën e implementimit të një operimi, mirëmbajtjeje dhe menaxhimi profesional të shërbimit të furnizimit të tyre me ujë dhe të ujërave të zeza: se uji është një aset i trashëguar dhe nuk duhet të harxhohet, i pashfrytëzuar.
- B2) Programe të ngritjes së vetëdijes mbi rreziqet mjedisore dhe të shëndetit si pasojë e mostrajimit të ujërave të zeza
- B3) Të nisen projekte për pranimin e tarifave
- B4) Të iniciohet zhvillimi i kapaciteteve dhe trajnimi për sipërmarrësit lokal siç janë hidraulikët, instaluesit e gypave sanitar dhe filterëve të gypave

C) Të përmirësohet planifikimi

- C1) Bashkimi i njësive të shërbimeve me Hidroregjionin Jugor (HRJ) bashkë me aprovimin e Masterplanit nga Komuna dhe MMPH.
- C2) Të përmirësohen kapacitetet komunale në planifikim
- C3) Të krijohet një sistem për ofrim të planit gjithëpërfshirës për implementimin e projekteve të reja
- C4) Ngritja e fondeve për riparim dhe rehabilitim si dhe për përmirësim p.sh. nga agjencitë donatore
- C5) Implementimi i një mekanizmi institucional për të siguruar finansimin

4 Aspektet relevante të gjendjes aktuale të mjedisit

4.1 Toka

Sipas Hartës së Tokave të Kosovës (1974/2006, 1:200.000) tokat në territor të komunës së Dragashit mund të përmbledhen në 8 klasa (shih: Figura 4; dhe Atlasin e Zhvillimit të Qëndrueshëm për Dragashin Vëll. 2 Baza, Kapitulli 1.4):

- Gurë të zhveshur, me gati aspak mbulesë dheu, rreth 1% e sipërfaqes, sidomos në malet e larta dhe të rrëpishme në jug;
- Litosolet e reja, të zhvilluara e të shpërndara, mbi gjitha llojet e gurëve, janë dominuese në pjesët e rrëpishme përgjatë luginave e maleve, si dhe mbulojnë rreth 9% të territorit;
- Faza e ardhshme e zhvillimit të dheut përfaqësohet nga ranker mbi gurët acidikë apo neutral, si dhe rendzina mbi gurë gëlqerorë. Këto dhera zakonisht janë të zhvilluara vetëm sipërfaqësisht, si dhe mbulojnë rreth 70% të Dragashit – rankerët në male përgjatë kufirit lindor dhe jugor, derisa Rendzinas në Masivin e Koritnikut në veri.
- Dherat e kaftë, karakteristike për rreth 13% të sipërfaqes, që janë më thellë të zhvilluar, si dhe mund të gjenden në një brez prej Breznës dhe Brrutit në veri deri në Krushevë në jug.
- Dherat e rrafshëve të lëmuara mbulojnë 7% të komunës, si dhe mund të gjenden përgjatë luginës së Pllavës në veri, në pjesët e ulëta të luginës së Lumit Brod, si dhe në pjesët e luginës së Lumit Restelicë përreth Restelicës.
- Deltinat dhe dherat organike kanë rëndësi të pakët pasi mbulojnë më pak se 1 përqind të territorit në total. Këto lloje mund të gjenden në zonën përreth Shutmanit, si dhe Liqenit të Breznës.

Bazuar në tipin e tokës, rrëpirës dhe tipit të shfrytëzimit aktual të tokës, rreziku nga erozioni është vlerësuar për territorin (shih gjithashtu: Figura 5; dhe Atlasin e Zhvillimit të Qëndrueshëm për Dragashin, Vëllimi 3 Vlerësimi, Kapitulli 1.4.1). Duke pasur parasysh rrezikun nga erozioni posaçërisht relevante për menaxhim të bujqësisë dhe kullosave dhe për çdo aktivitet të ndërtimeve, vlerësimi duhet të ketë pasoja për masa të parandalimit të riparimit të rrugëve dhe ndërtimeve si dhe për planifikim të aktivitetëve të pyllëzimit.

Zonat kryesore bujqësore të Opojës kanë vetëm rrezik të ulët deri të mesëm. Sidoqoftë, kërkohet menaxhim i kujdesshëm i kullosave intensive dhe i tokave të punueshme. Kjo përfshinë mirëmbajtjen/jo shkatërrimin e brezareve dhe të gardheve me shkurre në tokën e shfrytëzuar bujqësore. Rreziqet nga erozioni i tokës janë njëjtë të ulëta në kullosat e larta të Maleve të Sharrit, të cilat janë të karakterizuara me rrëpira të lehta. Zonat kryesore të tokave me rrezik të lartë të erozionit gjenden përgjatë shpateve të pjerrëta të luginave të Maleve të Sharrit dhe në Malin Koritnik.




Figura 4: Harta e tokave të Dragashit (AZhQ Harta B4)




Figura 5: Harta e erozionit të tokës (AZhQ Harta A4.1)

4.2 Uji

Për shkak të mesatares së lartë të rënies vjetore të shiut prej 1.130mm/m², komuna e Dragashit është një rajon i Kosovës me resurse të bollshme të ujit. Zona i takon tri ujëndarësve kryesor (Figura 6):

- Pjesa veriore e territorit të komunës i takon pellgut të Drinit të Bardhë që derdhet në Detin Adriatik (36.556ha = 84% të territorit), që përbën nënpellgjet e lumit Restelica, lumit Brod, lumit Stoke, lumit Pllavë dhe lumit të Prizrenit. Pjesa e territorit të Dragashit që derdhet në lumin e Prizrenit karakterizohet nga një veçori gjeologjike: Nuk ka rrjedhë të ujërave sipërfaqësore për në lumin e Prizrenit. Afër liqenit të Breznes uji shkon nëpër një batak dhe një lidhje nëntokësore karstike, afër fshatit Poslisht në rrethinë të Prizrenit, uji buron te vendi i quajtur “Gurra”.
- Pjesa më jug-perëndimore e territorit të Komunës i përket pellgut të Lumit të Drinit të Zi që derdhet gjithashtu në Detin Adriatik (6.532ha = 15% e territorit).
- Dy zona të vogla në jug-lindje të territorit derdhen nëpër Lumin Vardar në Detin Egje (494ha = 1% e territorit).

Ekosistemet që ofrojnë regjenerim të resurseve të ujit dhe kështu e zbusin shkarkimin e shpejt të shiut apo të shkrirjes së borës, p.sh. të gjitha llojet e pyjeve dhe ligatinave janë në mënyrë unke të distribuara në nënpellgjet e Komunës. Tabela 2 paraqet një pasqyrë të situatës:

- Nënpellgjet jugore që gjenden në rajonin e Gorës karakterizojnë dukshëm më pak zona regjeneruese sesa pellgjet veriore; gjithë nën 20% të sipërfaqes së nënpellgjeve përkatëse. Kjo është veçanërisht e shkaktuar për shkak të mbulesës më të ultë malore, por pjesërisht e nivelizuar nga bollëk i madh i ligatinave në zonat më të larta malore. Të dy faktet që avokojnë për mbrojtje të efijencës të këtyre tipeve të ekosistemeve në rajonin e Gorës.
- Në nënpellgjet veriore mbulesat e larta të krahasueshme të pyjeve dhe të pyjeve cungishte llogarisin për një proporcion më të lartë të zonave regjeneruese të ujit. Më të spikaturat janë zonat e mëdha pyjore në Malin Koritnik dhe në nënpellgun e lumit Sotke.
- Në përgjithësi pjesa e zonave të rigjenerimit të ujit në komunën e Dragashit llogaritet pak mbi 20%.

Tabela 2: Zona e rigjenerimit të resurseve të ujit për ujëndarës

Pellg / Nënpellg	Zona për rigjenerim të resurseve të ujit në ha				në % të sipërfaqes totale	Sipërfaqja totale në ha
	Pyjet	Pyjet cungishte	Ligatina	Totali		
<i>Drini i Bardhë</i>	4.300	3.295	998	8.593	24%	36.556
Lumi Brod	553	712	389	1.655	19%	8.789
Lumi Pllavë	2.237	1.982	283	4.502	26%	17.573
Lumi i Prizrenit	491	431	15	936	38%	2.435
Lumi Restelicë	564	135	311	1.011	14%	7.155
Lumi Sotke	455	35	0	490	81%	603
<i>Drin i Zi</i>	1		831	832	13%	6.532
Lumi Guri i Zi	1		463	464	12%	3.757

Lumi Sherupa	0		368	368	13%	2.775
<i>Vardari</i>	0		60	60	12%	494
Lumi Rrasangult	0		9	9	6%	160
Lumi Ujërat e Qeta	0		50	50	15%	333
Totali komuna e Dragashit	4.301	3.295	1.889	9.485	22%	43.581

Zonat e rëndësishme ekologjike të lidhura me ligatinat/mbulesat ujore të hapura 1.892 ha (4,3%) të zonës së Dragashit. Sipas nenit 55 të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, mbrojtja e ligatinave shprehet kështu:

1. Ligatinat përfshirë ujërat, në kuptim të këtij ligji përfaqëson vlerat e natyrës dhe për këtë ato duhet të ruhen në një gjendje natyrore apo gati natyrore.
2. Për rastin e mbrojtjes së ligatinave, përfshirë ujërat që nuk janë të rregulluara me këtë ligj, do të aplikohen dispozitat e akteve të posaçme.
3. Çdo liqe natyral apo pellg, afër argjinaturave më të mëdha se 0,01 ha, kënetë natyrore apo artificiale që matë më shumë se 0,25ha, burim dhe përroska në breg prej dy (2) metrash, në kuptim të këtij ligji përfaqëson zonë të rëndësishme ekologjikisht.




Figura 6: Ujëndarësit në komunën e Dragashit

Kualiteti i ujit:

1. Dy kërkimet fushore, një në sezonin e rrjedhës së madhe të ujit (2011) dhe një në sezonin e rrjedhës së ultë të ujit (2012) që është shfrytëzuar një sistem i indikatorit biologjik dhe ka

treguar se 36% e 45 vendeve të mostruara patën kualitet mesatar deri shumë të dobtë dhe 64% kualitet të shkëlqyeshëm deri shumë të mirë (gjatë sezonit të lagësht) (shih Ibrahim H. 2011b dhe 2012 dhe UNDP, 2012b, ju lutem referohuni Figura 7; dhe Hartës A3.1 nga AZhQ).

2. Ndotja nga kanalizimet është signifikante. Ripat e lumenjve në rrjedhën nën vendbanime janë në përgjithësi të ndotur nga ngarkime organike prej vendbanimeve. Ndotja më e rëndë mund të vërehet në Lumin Pllavë nga rrjedha e lumit nën Zaplluxhe deri te pika e fundit e mostrimit në rrjedhën e lumit nën fshatin Rrenc. Impianti për trajtimin e ujërave të zeza që aktualisht është duke u ndërtuar në rrjedhën e lumit nën fshatin Kosavë vetëm do të zvogëlojë ngarkesën hyrëse shtesë në lumin Pllavë nga lumi Kapre. Kjo mund të ndikojë pozitivisht në kualitetin e ujit në lumin Pllavë në rrjedhën nën fshatin Zym.
3. Shumica e zgjatjeve të lumenjve në rrjedhat nën fshatra janë të ndotura me mbeturina të ngurta.

Hidrocentralet:

1. Momentalisht një hidrocentral i vogël (HCV) është duke operuar përgjatë lumit Brod afër fshatit Baçkë.
2. Dokumentet e planifikimit për ndërtimin e HCVve përgjatë lumenjve Brod dhe Restelica janë në proces të aprovimit. Për fat të keq autoritetet nuk kanë siguruar ndonjë informatë hapësinore apo teknike lidhur me këto projekte. Prandaj, ndikimet e tyre mjedisore nuk mund të vlerësohen plotësisht. Në çdo rast këto projekte duhet të shqyrtohen kur të ndërmerret VSM lidhur me resurset e ujit në Dragash.
3. Skema e planifikuar e Hidrocentralit Zhur do të jetë skemë kulmore e hidroenergjisë me një kapacitet të instaluar pre 305MW. Dy impiantet do të jenë vendosura jashtë komunës së Dragashit afër fshatit Zhur. Nëpërmjet një sistemi të tuneleve dhe kanaleve uji do të transferohet nga nënpellgu i lumit Guri i Zi , nga lumenjt Brod dhe Restelica deri te rezervoari i parë i vogël në luginën e lumit Pllavë, dhe nga aty deri tek një rezervoar i dytë më i madh afër fshatit Brezne. Nëpërmjet një tuneli uji do të shkojë teposhtë në hidrocentrale, prej aty me një dallim të lartësisë prej 643, respektivisht 683,5m deri te dy hidrocentralet. Rrjedhat e ujit të lumenjve Caljane, Restelicë, Brod dhe Pllavë do të ndikohen, si dhe rrjedha e ujit karstik prej afër liqenit Brezne deri në "Gurrë". Vendimet ligjore për ngritjen e Hidrocentralit Zhur është marrë nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 24 korrik 2009.

Shkema e Hidrocentralit Zhur nuk është çështje direkte e VSM por duhet të shqyrtohet si një ndikim shtesë.




Figura 7: Vlerësimi i resurseve natyrore të ujërave (AZhQ Harta A3.1)

4.3 Ajri

Asnjë informatë e detajshme kualitative mbi ajrin në komunën e Dragashit nuk është në dispozicion. Sidoqoftë, situata në vijim mund të merret parasysh:

1. Kualiteti i përgjithshëm i ajrit në Dragash mund të konsiderohet si e mirë deri shumë e mirë, posaçërisht në zonat e gjera të pabanuara të maleve.
2. Brenda vendbanimeve dhe në rrethinën e afërt të tyre pak ndotje e ajrit e shkaktuar nga emitimi i nxemjes së ndërtesave duhet të vëzhgohet gjatë sezonit të nxemjes. Ndotja është e pavarur nga materiali i nxemjes (dru apo bajgë e tharë).
3. Gjatë verës dhe fillimit të vjeshtës zjarret e pyjeve mund të shkaktojnë emitim signifikant që gjithashtu mund të ndikojë në kualitetin e ajrit në fshatrat përreth..
4. Bezdisjet nga kutërbimet të shkaktuara nga industritë lokale deri më tani nuk janë raportuar.

4.4 Faktorët klimatik

Komuna ka një klimë subalpine me temperaturë mesatare vjetore prej 8,6° Celsius për Dragashin.

Kulminacioni i rënies së shiut është në korrik, kulminacionet nënrenditëse janë në shtator dhe nëntor, muajt më të thatë janë janar deri në mars dhe gusht. Përafërsisht 50% të rënies së shiut janë gjatë periudhës së vegjetacionit.




Figura 8: Diagrami i klimës për Dragashin

Tabela 3: Temperatura mesatare stinore në Dragash

Temperatura	Dimër	Pranverë	Verë	Vjeshtë	Periudha e vegjetacionit
-------------	-------	----------	------	---------	--------------------------

mesatare në Dragash °C	-0.4	7.9	18.1	10.2	15.0
---------------------------	------	-----	------	------	------

Tabela 4: Rëniet dhe temperatura mesatare gjatë periudhës së vegetacionit

Rëniet dhe temp. mesatare gjatë periudhës së vegetacionit	Prill deri Shtator			Tetor deri Mars			Vjetore		
	mm	%	Temp. °C	mm	%	Temp. °C	mm	%	Temp. °C
Sharr Dragash	413	51.1	15.0	394	48.9	3.3	807	100	8.3

4.5 Biodiversiteti, përfshirë florën dhe faunën

4.5.1 Flora dhe vegetacioni

Altitudet që sillen mes 730 dhe 2.650 m mbi nivelin e derit, llojllojshmëri e madhe bjeshkësh dhe tokash, dhe ndikimet nga klimat mesdhetare dhe kontinentale, të gjitha këto nxisin zhvillimin e diversitetit të specieve të ndryshme bimore dhe të komuniteteve në komunën e Dragashit. Malet e Sharrit supozohet të japin habitate me rreth 2000 specie bimore vaskulare. Studimi në Malet e Sharrit ka pasqyruar përafërsisht rreth 650 specie bimore. Është e rëndësishme të theksohet që janë rregjistruar vetëm disa pika të rëndësishme dhe jo e tërë lista totale e bimëve.

Pa ndikimin njerëzor, shumica e sipërfaqeve nën zonat drunore janë të mbuluara me male. Përgjatë shekujve të shpyllëzimit, shtresimit dhe djegieve të shpeshta të drunjve dhe shkurreve, pyjet janë zhdukur pothuajse plotësisht në pjesën lindore dhe jugore të komunës në altitute mbi 1.700 m (Malet e Sharrit).

Zona drunore është rreth 2000 – 2100 m dhe është më e pranishme në Malin Koritnik në Veri – Perëndim të komunës. Mund të thuhet që kushtet e kësaj zone drunore janë më të afërtat për ekosistemet natyrore. Këto janë zonat e mbuluara me shkëmbinj natyrore, bar alpine dhe shkurre me toka të njoma li moçale me torfë dhe moçale në depresione me varietetet të madh të komuniteteve me bimë tipike dhe specie të rëndësishme.

Pyjet në Dragash janë përzierje e pyjeve halore që dominohen nga pishat apo bredhët dhe pyjet me dru ahu, lisa, thupra dhe shkozë, apo përzierje e këtyre dy të fundit. Përafërsisht 40% e pyjeve në komunë janë të pak a shumë të manxuara si pyje zabele. Përgjatë vijave ujore të pyjeve bregore dominojnë verr të begatë.

Pyjet e Dragashit përbajnë një varietetet të madh të komunitetit bimor dhe specieve me rëndësi. Zabelet janë kryesisht të pasura me numër të madh të llojeve bimore dhe shtazore.

Lendinat dhe kullosat zëvendësojnë pyjet natyrore dhe kryesisht përmbajnë një varietet të shumtë të llojeve bimore.

Tokat dhe zonat e punueshme kanë një përzierje komplekse të kultivimit të tokës së lëruar, kulturave permanente, kullotave etj, ndërsa shpesh gardhet nuk ishin në fokus të punës së ndërmarrë në terren. Në veçanti zonat me diversitet të madh të strukturave janë tejet të rëndësishme për faunën lokale.

Bashkësitë bimore

Gjatë punës në terren dhe pranë kompjuterit për përpilimin e SDA, janë identifikuar 37 bashkësi bimore në zonat fokale (shih B. Mustafa, 2011) dhe Tabelën 2.3 në Kaptinën 2.3 Volumi 2 i SDA . Një listë dhe përshkrimi i plotë mund të gjendet tek Volumi 5 Atlasi për Zhvillim të Qëndrueshëm. Tabela 5 prezanton bashkësitë bimore që mund të identifikohen në terren dhe mund të harmonizohen me dispozitat e Shtojcës I dhe Direktivën e BE-së për Florën dhe Faunën, prandaj janë shumë të rëndësishme për çështjet e biodiversitetit (përshkrimi i marrë pjesërisht nga B. Mustafa, 2011).

Tabela 5: Bashkësitë bimore të identifikuar në komunën e Dragashit

Bashkësia bimore (emri shkencor)	Përshkrimi	Habitat-Direktiva Shtojca I Lloji
<i>Vegjetacion në lagështira</i>		
Caricetum – varietete të ndryshme	Caricetum nigrae, Caricetum rostratae salicetosum, Caricetum rostratae-vesicariae: bashkësitë që formojnë torfa në sipërfaqen e ujërave oligotrofe e mezotrofe, me karakteristika mesatare mes llojeve soligjene dhe ombrogjene.	7140 Transition mires and quaking bogs
Carici-narthecietum scardici	Lagështirat të mbuluara kryesisht me torfa apo tufa që prodhojnë bashkësi myshqe plishi dhe të kafta që gjenden në toka tërësisht të mbyllura nga uji , me furnizim uji qëlqeror soligjen apo topogjen, me shtresë mbi apo nën ujë, substratum	7230 Alkaline fens
<i>Vegjetacioni eutrofik</i>		
Senecio-Rumicetum alpini	Herb të gjata nitrofile në vendet malore dhe alpine ku pushojnë bagëtitë.	Nuk gjendet në Shtojcën I
<i>Vegjetacioni i shkurreve</i>		
Arctostaphylo-Juniperetum nanae	Zona alpine mbi zonën e fundit të pyllit. Speciet karakteristike janë Juniperus nana, Vaccinium uliginosum, Thymus albanus, Nigritella nigra etj.	4060 shkurret Alpine dhe Boreal
Vaccinio-Empetretum hermaphroditi	Shkurre boronice në malet e larta Vaccinium-shkurre të ulta të brezit të maleve jugore. Me Vaccinium myrtillus, Vaccinium uliginosum s.l. Vaccinium vitis-idaea dhe lokalisht me Empetrum nigrum. Ato janë të pasura me specie të barishteve dhe shpesh marrin pamjen e barishteve alpine me shkurre të ulta.	4060 shkurret Alpine dhe Boreal –shkurret malore të boronicave
Vaccinion with V. gaultherioides	Shkurret e ulta të dominuara nga Empetrum hermaphroditum, Vaccinium uliginosum, me Arctostaphylos alpina, Vaccinium myrtillus, Vaccinium vitis-idaea dhe lycopodes	4060 shkurret Alpine dhe Boreal shkurret e maleve të larta - shkurret Empetrum-Vaccinium
Corylletum avellanae	Diversiteti i specieve është më i madh sesa tek pyjet bregdetare	91K0 Illyrian Fagus

Bashkësia bimore (emri shkencor)	Përshkrimi	Habitat-Direktiva Shtojca I Lloji
	në Evropën Qëndrore dhe Aremonio-Fagion përbën një qendër të rëndësishme të diversitetit të specieve	sylvatica forests (Aremonio-Fagion)
Alpine lawns and rock vegetation		
Drypetum spinosae	Asociacioni gjendet në lartësi 2000m. Zhvillohet në vende shkëmbore. Ky asociacion është i varfër në specie. Speciet më të rëndësishme janë Drypis spinosa, Linaria alpina, Festuca picta etj.	8140 Eastern Mediterranean screes
Saxifrageto-Potentilletum apenninae	Ky asociacion gjendet në Malet Sharrit dhe Koritnikut në shkëmbinj të gëlqeror. Komponente të këtij asociacioni janë specie tretësore dhe relikte. Speciet më të rëndësishme janë Potentilla speciosa, Potentilla apennina, Saxifraga scardica, Aubrietia gracilis, Minuartia graminifolia	6110* Rupicolous calcareous or basophilic Fushat of the Alysso- Sedion albi
Saxifrageto-Rumicetum nivalis	Lëndina të zhveshura të ekspozuara erës Meso-xerophile, relativisht të mbyllura dhe lëndina të joskulpturuara të Kobresia myosuroides (Elyna myosuroides) që formohen në toka të thella dhe vargmale të zgjatura që u ekspozohen erërave të fuqishme në nivelet alpine dhe nën dëborë.	6170 fusha subalpine dhe gëlqerore
Juncetum trifidi	Formacionet Boreo-alpine të maleve të larta me h Juncus trifidus, Carex bigelowii, myshqe dhe likene. Gjithashtu janë të shoqëruara me komunitete në shtretër bore.	6150 fushat veriore dhe Siliceous alpine
Fushat natyrore		
Varietete të ndryshme të Nardion	Deltoideo-Nardetum, Nardion, (Lino-)Nardetum strictae: Nardus stricta është kryesues i asociacionit. Komunitetet e bimëve të larta të niveleve pyjore dhe alpine të klasit Betulo-Adenostyletea , apo fusha Nardus të mbyllura, të thata apo mezofile që mbulojnë tokat në Atlantik apo sub-Atlantik, apo toka veriore, male dhe regjione pyjore. Vegetacioni i ndryshueshëm por variacioni përcillet me vazhdimësi.	6230* Species-rich Nardus Fushat , on siliceous substrates in montane and sub- montane areas
Armerio-Festucetum variae	Above Pinetum heldreichii typicum	6170 Fushat gëlqerore alpine dhe subalpine
Carici-Seslerietum latifoliae	Fusha kurorë dhe stepe Kalcifile Xerothermophile, të hapura, të skulpturuara, fusha kurore apo stepe	6170 Fushat gëlqerore alpine dhe subalpine
Diantho-scardici-Festucetum	Fusha stepe dhe kurorë	6170 Fushat gëlqerore alpine dhe subalpine
Kullota të gjera		
Gentiano-Dryadetum octopetalae	Fushat stele kalcifile dhe gëlqerore në pikat më të larta të Malit Koritnik . speciet karakteristike janë Dryas octopetala, Gentiana verna, Carex leavis, Helianthemum canum. Specie tjera të rëndësishme janë Thymus albanus, Edrianthus graminifolius, Scabiosa columbaria, Gentiana kochiana etj.	6170 Fushat gëlqerore alpine dhe subalpine
Helianthemo-Globularietum bellidifoliae and Edraiantho-Elynetum	Breza të zhveshura - Meso-xerophile, breza mali relativisht të mbyllura dhe të paskulpturuara të Kobresia myosuroides (Elyna myosuroides) që formohen në toka të thella të vargmaleve të ekspozuara erërave të fuqishme në nivelet alpine dhe të dëborës	6170 Fushat gëlqerore alpine dhe subalpine
Gladiolo-Sanguisorbetum officinalae	Livadhe sanash të pasura me specie në toka pak apo mesatarisht të fertilizuara të niveleve të rrafshta apo nën-kodrinore, që i	6510 livadhe sanash të tokave të ulta

Bashkësia bimore (emri shkencor)	Përshkrimi	Habitat-Direktiva Shtojca I Lloji
	takojnë aleancave të Arrhenatherion dhe Brachypodio-Centaureion nemoralis. Këto fusha të gjera janë të pasura me lule dhe nuk kositen para lules së barit dhe më pas vetëm një herë apo dy herë gjatë vitit.	(Alopecurus pratensis, Sanguisorba officinalis)
Xerobromion	Fusha të hapura të thana në dhe pak a shumë gëlqeror	6120* Xeric sand fusha gëlqerore
Coniferous forest		
Abietum borisii-regis	Gjendet në mënyrë tipike në Ballka, dhe në Kosovë gjendet vetëm në Malet e Sharrit (në Restelicë), në lartësi prej 1500-1580m. Në pjesën lindore. Prani e lartë, e karakterizuar me prani të Abies borisii-regis, Doronicum caucasicum, Galium laconicum, Lathyrus venetus, Helleborus cyclophyllus.	9270 Ahishte helenike me Abies borisii-regis
Abietum albae koritniensis	Pyjet e Abies alba apo Abies alba përzier me Fagus sylvatica, Picea abies, Pinus sylvestris apo Pinus nigra brenda zonës gjeografike të pyjeve Fagion moesiacum.	91BA pyje bredhi gri Moesian
Pinetum heldreichii typicum	Pyje pishash të bardha : formacione lokale të trungut Pinus heldreichii të kufizuara vetëm për Ballkanin jugor, Greqinë veriore dhe Italinë jugore, zakonisht të hapura dhe fushat nën to mbi toka të thata shpesh shkëmbore apo gurore.	95A0 Pyje pishat të larta oro-Mediterranean
Mixed forest		
Fago-Pinetum heldreichii	Pyje pishash të bardha : formacione lokale të trungut Pinus heldreichii të kufizuara vetëm për Ballkanin jugor, Greqinë veriore dhe Italinë jugore, zakonisht të hapura dhe fushat nën to mbi toka të thana shpesh shkëmbore apo gurore.	95A0 High oro-Mediterranean pine forests
Riparian forest		
Alnetum glutinosae	Tipike për lugina lumenjsh në terrene shpesh të vërshueshme me lagështi të madhe. Në shtresat e drunjve dominon Alnus glutinosa dhe në shtresa shkurresh gjenden Euonymus europea, Prunus padus, Viburnum opulus. Speciet herbakus janë Viola sylvestris, Euphorbia palustris, Teucrium chamaedrys, etj.	91E0 pyjet aluviale me Alnus glutinosa dhe Fraxinus excelsior (Alno-Pandion, Alnion incanae, Salicion albae)
Birch forest		
Betuletum verrucosae koritniensis	Pyjet Fagus sylvatica. Diversiteti i specieve është më i madh sesa në ahishtet në Evropën Qendrore dhe Aremonio-Fagion përbën një qendër të rëndësishme të diversitetit të specieve.	91K0 Pyjet Illyrian Fagus sylvatica (Aremonio-Fagion)
Oak forest		
Lembotropo-Quercetum cerris		Locally defined
Quercetum trojanae dukagjini	Zhvillohen në Koritnik në lartësi prej 300-900m. Përbërja gjeologjike është gur gëlqeror dhe mbulesa pedologjike është e kuqe. Ky asociacion është nën ndikimin e klimës mesdhetare që vjen nga luginat e lumit Drini i Bardh. Në ndikimin e faktorit njeri, në një pjesë të madhe në vend të specieve Quercus trojana species zhvillohet Carpinus orientalis dhe Crataegus monogyna. Speciet karakteristike për këtë asociacion janë Quercus trojana dukagjini, Pyrus amygdaliformis, Ruta graveolens, Acanthus balcanicus etj.	9250 Quercus trojana woods
Beech forest		

Bashkësia bimore (emri shkencor)	Përshkrimi	Habitat-Direktiva Shtojca I Lloji
Fagetum moesiaca montanum	Fagus sylvatica or pyjet Fagus moesiaca. Fagus sylvatica shoqërohet në lartësi të mëdha dhe të vogla, nga Abies alba dhe Picea abies. Pyjet posedojnë, mandje edhe në jug të tyre një karakter të theksuar medio-evropian që shënohet nga shpeshtësia e specieve si Acer pseudoplatanus, Quercus petraea, Fragaria vesca, & Oxalis acetosella.	91W0 Moesian beech forests
Colurno-Ostryetum carpiniifolia	Pyjet Fagus sylvatica me diversitetin e specieve më të madh sesa ahisitet në Evropën Qendrore dhe Aremonio-Fagion përbën një qendër të rëndësishme të diversitetit të specieve.	91K0 Illyrian Fagus sylvatica forests (Aremonio-Fagion)
Hornbeam forest		
Dioscoreo-Carpinetum orientalis	Pyjet me lisa të bardhë Moesian, Thermophilous, sub-Mediterranean Quercus pubescens dhe pyjet Quercus virgiliana.	91AA *pyjet lindore me lisa të bardhë

Speciet

Gjatë punës në terren të ekspertëve të UNDP-së dhe një grupi shkenctarësh vendor (Prof. Dr. F. Milaku në mesin e tyre.) kanë elaboruar listën e kuqe të Kosovës. 650 specie të bimëve mund të lokalizohen në territorin e komunës. Një listë prej 37 specieve janë konsideruar të jenë më të rëndësishmet dhe më të rrezikuara në komunë, nga B. Mustafa (2011). Kjo listë paraqitet në Tabelën 6:

Tabela 6: Lista e llojeve të bimëve më të rëndësishme dhe të rrezikuara

Speciet	Emërtimi shqip	Emërtimi serbisht	Emri anglisht
Abies alba subsp. borisii-regis	Bredhi i maqedonisë	Makedonska Jela	Bulgarian Fir
Achillea holosericea	Barpezmi i gjithëmëndafshë		
Colchicum macedonicum	Xhërrokulli maqedon	Makedonski Balučak-Mrazovac	Macedonian saffron
Crepis macedonica	Shmanga maqedonase	Makedonska Čekinjuša	Macedonian hawkbeard
Dianthus scardicus	Karafili i Sharrit	Šarplaninski karanfil	Sharr pink
Draba korabensis	Draba e Korabit		Korab's whitlow
Draba scardica	Draba e Sharrit		Scardica whitlow
Drypis spinosa	Dripis		
Erysimum pectinatum			
Festuca koritnicensis	Bishtëpelëza e Koritnikut	Vlasulja Koritnika	Koritnik fescue
Gentiana lutea	Sanëza e verdhë	Srčanik	Yellow Gentian
Geranium subcaulescens			Dwarf Cranesbill
Juncus triglumis	Kulmaku	Sit	Yosemite dwarf rush
Linaria peloponesiaca	Linaria peloponeze		Peloponesiac Toadflax
Minuartia baldaccii	Minuarcia e Baldaçit		
Pinus heldreichii	Rrobulli	Munika	Bosnian Pine
Potentilla calabra	Zorrëca Kalabreze		Calabrese cinquefoil
Primula halleri	Aguliçe e Hallerit	Hallerov jaglac	Haller's Primrose
Ranunculus demissus var. Graecus Boiss	Zhabina e ulët		

Ranunculus montenegrinus	Zhabinorja malazeze		Montenegro's buttercup
Rhamnus orbiculatus	Pjerrëza rrethore		Buckthorn
Saxifraga scardica	Iriqëza e Sharrit	Šarplaninska kamenika	Scardica saxifrage
Scrophularia aestivalis	Skrofularja e verës		Autumn figwort
Senecio scopolii	Pulithi i Skopolit		
Silene pusilla	Klokëza e vockël	Mala pušina	
Spargularia vellesia subspecies graminea	Spargularia		
Thalictrum alpinum	Taliktri alpin		Alpine Meadow-rue
Thlaspi bellidifolium	Tlaspi gjethebukur	Čestika	Penny-cress
Thlaspi microphyllum	Tlaspi gjethevogël	Mala Čestika	Little leave Penny-cress
Thymus albanus	Listra shqiptare		Albanian thyme
Thymus doerfleri	Listra e Dorflerit		Dorfler thyme
Tozzia alpina	Tocia alpine		Alpine tozia
Triglochin palustris	Triglohini kënetor	Močvarna brula	Marsh Arrowgrass
Valeriana bertisceae	Haraqina e Bertiskut		Bertisce Valerian
Valeriana pancicii	Haraqina e Pancicit	Pančićev odoljen	Pancici Valerian
Veronica saturejoides	Veronika si shtërmën		Savory Leafed Speedwell
Viola grisebachina	Vjollca e Grisebakut	Grisebah ljubičica	Grisebach violet

Përmbledhje e vlerësimit:

Figura 9: Vlerësimi i vegjetacionit dhe florës (AZHQ Harta A1.1) thekson statusin ekzistues (të qenët të rrallë) kryesisht të pyjeve, tokave kufitare dhe lagështirave.

Hartat tregojnë qartë që shumica e zonave ekologjike gjenden brenda zgjerimit të propozuar të Parkut Nacional të Maleve të Sharrit. Kjo vërteton të gjeturat (dhe ofron detaje shtesë) të identifikimit preliminar të Vendndodhjeve Natura 2000 në Kosovë (B. Mustafa et al. 2009).

Zabelet, lëndinat e gjera dhe fushat e thata gjithashtu kanë vlerë të lartë biodiversiteti. Por këto lloje vegjetacioni varen nga menaxhimi (tradicional) i shfrytëzimit të tokave. Resurset e vegjetacionit dhe të florës janë në kuadër të informatave për strategjinë e përgjithshme për konzervim dhe do të kombinohet me vlerësimin e faunës dhe funksionet ekologjike të pyjeve për qëllime të udhërrëfyesi të përgjithshëm për konzervim të natyrës.

Definicioni i llojit tjetër të zonave të mbrojtura sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe zonimin e Parkut Nacional mund të bazohet në këtë vlerësim.

Tabela 7: sipërfaqja dhe përqindja e llojeve të habitatit në harta, të cilat janë të mbrojtura sipas Direktivës së BE_së për Habitat Flora-Fauna-

Vegjetacioni	Llojet e habitatit të mbrojtura sipas Direktivës së BE-së për Habitatin Flora – Fauna	Gjithsej në ha
--------------	---	----------------

	Shtojca I	Shtojca I* (habitatet prioritare)	
Pyjet	2.933,9	397,1	3.331,1
<i>Në % të komunës</i>	6,7%	0,9%	7,6%
Fushat	1.483,8	13,9	1.497,7
<i>Në % të komunës</i>	3,4%	0,0%	3,4%
Kullotat	24,7	611,3	636,0
<i>Në % të komunës</i>	0,1%	1,4%	1,5%
Zonat shkëmbore	597,7	9,1	606,9
<i>Në % të komunës</i>	1,4%	0,0%	1,4%
Shkurret dhe/apo vegjetacioni herbal	107,5		107,5
<i>Në % të komunës</i>	0,2%	0,0%	0,2%
Lagështirat, trupat ujor	66,5		66,5
<i>Në % të komunës</i>	0,2%	0,0%	0,2%
Gjithsej sipërfaqja në hartë	5.214,1	1.031,4	6.245,6
<i>Në % të komunës</i>	12,0%	2,4%	14,3%

Tabela 8: sipërfaqja dhe përgjindja e llojeve të vegjetacionit /shfrytëzimi i tokave me potencial të lartë për biodiversitetin e bimëve

Sipërfaqet specifike me potencial të lartë për biodiversitetin e bimëve	Sipërfaqet jashtë llojeve të habitateve të listuara në Shtojcën I Direktiva e BE-së për Habitat - Flora-Fauna (në ha)	Në % të territorit të Dragashit pyjet
Pyjet me regjenerim natyral	1.023,4	2,3%
Ahishtet dhe shkurret	4.785,2	11,0%
Vegjetacioni i hapur gjysmë natyror	17.071,2	39,2%
I karakterizuar me shkëmbinj dhe zhavor	694,6	1,6%
Gjithsej sipërfaqja me potencial të lartë	23.574,5	54,1%

Tabela 9: Numrat e specieve bimore të rëndësishme

Lista e referencës	Nr. i specieve bimore të listuara të gjetura në territorin e Dragashit
IUCN Lista e Kuqe (kategoritë afër kërcënimit apo të ndjeshme)	2
Direktiva e BE-së për Habitat - Flora-Fauna – Shtojca II	4
Direktiva e BE-së për Habitat - Flora-Fauna – Shtojca V	2
Rekomanduar për Listën e Kuqe të Kosovës të rradhës	119




Figura 9: Vlerësimi i vegjetacionit dhe florës (AZHQ Harta A1.1)

4.5.2 Fauna

Për shkak të diversitetit të shfrytëzimit të tokave dhe strukturave të pejsazhit , territori i komunës së Dragashit ofron varietet më të lartë për habitatet e grupeve të shumta dhe specieve të shtazëve. Përveç fushave të hapura, pyjeve të larta, ahishteve, të gjitha lloeve të tokave të lagështa, zovat me shkëmbinj dhe zhavor gjithashtu kanë shumë rëndësi.

Nuk ka studime sistematike të disponueshme për faunën në Dragash. Por të dhënat nga OJQ-të, fshatarët, informatat e shpërndara nga literatura dhe konstatimet e ekspertëve të UNDP ofrojnë bazën të mirë për një pasqyrë të përgjithshme për faunën lokale.

Gjitarët:

- **Arinjtë e kaftës (Ursus arctos):** një prej karakteristikave të Maleve të Sharrit. Arinjtë në pyje (si një pyllin në lindje të fshatit Bresanë dhe Blaç, në malin Koritnik apo në Ahishtet helene/bredhat mes Restelicës dhe Krushevës) dhe ato kalojnë kufirin në pjesët më të largëta në juglindje dhe vazhdimi tek Parku Nacional i Sharrit në verilindje. Arinjtë rrallë herë shihen në pyjet e larta të Fushat dhe në qendër të regjionit të Opojës.
- **Rrëçebulli (Lynx lynx):** rrëçebulli ka një shpërndarje të ngjashme si ariu në zonat pyjore dhe kufijtë pyjor në lartësi të mëdha dhe në kufinj të me Shqipërinë.
- **Ujqit (Canis lupus):** kudo nëpër ato vende
- **Dhitë e egra (Rupicapra rupicapra):** në diapazone më të larta dhe dalje shkëmbore, rrëpira të zonave alpine dhe subalpine
- **Kaprolli (Capreolus capreolus):** pak a shumë në tërë territorin në lartësi të vogla (ngjashëm si me dhinë e egët)
- **Derrat e egët (Sus scrofa):** në një zonë të njëjtë si Kaprolli – më afër tokave bujqësore

Zogjtë:

OJQ Finches ka ofruar informata për zogjtë për periudhën 2004 deri 2010, për 11 lokacione në komunë. Gjatë kësaj periudhe janë konstatuar gjithsej 153 specie zogjsh. Lokacionet individuale njehsojnë rreth 27 dhe 85 specie të ndryshme. Përafërsisht një e treta e këtyre specieve janë të listuara në Shtojca të ndryshme të Direktivës së BE-së për Zogjtë (shih Figura 10 dhe Tabela 10). Të gjeturat tregojnë diversitet të madh të specieve të zogjëve në komunë. Zonat e observuara paraqesin lloje të ndryshme të pejsazheve dhe habitateve të pranishme në komunë.

Tabela 10: Speciet e zogjëve të Dragashit të listuara në Shtojcën e Direktivës së BE-së për Zogjtë

Speciet (të renditura sipas familjeve)	Speciet (të renditura sipas familjeve)
Accipitriformes – zogjtë grabitçar	Gruiformes – Flufftails and Crakes
Accipiter brevipes	Crex crex
Accipiter gentiles	Rallus aquaticus
Aquila chrysaetos	Passeriformes – Passerines
Aquila heliaca	Anthus campestris

Circus cyaneus	Corvus corone cornix
Anseriformes - Waterfowls	Corvus frugilegus
Anas platyrhynchos	Corvus monedula
Caprimugliformes - Nightbirds	Ficedula albicollis
Caprimulgus europaeus	Ficedula parva
Charadriiformes – Waders and Gulls	Ficedula semitorqua
Tringa totanus	Lanius collurio
Ciconiiformes – Storklike Birds	Lanius minor
Nycticorax nycticorax	Lullula arborea
Columbiformes – Doves and Pigeons	Luscinia svecica
Columba livia	Melanocorypha calandra
Columba oenas	Parus ater
Columba palumbus	Pica pica
Sreptopelia decaocto	Pyrrhocorax pyrrhocorax
Streptopelia turtur	Pyrrhula pyrrhula
Falconiformes - Falcons	Sylvia nisoria
Falco columbarius	Troglodytes troglodytes
Falco naumanni	Turdus merula
Falco peregrinus	Turdus philomelos
Galliformes - Gamefowl	Turdus pilaris
Bonasa bonasia	Turdus viscivorus
Coturnix coturnix	Piciformes - Woodpeckers
Perdix perdix	Dendrocopos leucotos
Tetrao tetrix	Dendrocopos major
Galliformes	Dryocopus martius
Alectoris graeca	Strigiformes - Owls
	Asio flammeus
	Bubo bubo

Fluturat:

40 specie fluturash janë regjistruar deri tani në kullotat e maleve të larta dhe ahishtet. Duhet përmendur një diversitet të theksuar në kullotat malore dhe ahishtet nga të cilat 30 specie janë të përmendura në Shtojca II apo IV të Direktivës së BE-së për Habitat, apo janë vlerësuar si ‘të rrezikuara’ apo ‘të ndjeshme’ nga IUCN (shih Figura 10 dhe Tabela 11).

Tabela 11: Speciet e fluturave të regjistruara në Dragash me statusin IUCN të rrezikuara apo të ndjeshme apo të listuara në Shtojcën II apo IV të Direktivës së BE Habitat

Speciet (të renditura sipas familjeve)	Emërtimi Anglisht	Emërtimi shqip	Emërtimi sërbisht	Direktiva e BE-Habitat	Statusi IUCN
Hesperidae – Skippers					

Speciet (të renditura sipas familjeve)	Emërtimi Anglisht	Emërtimi shqip	Emërtimi sërbisht	Direktiva e BE-Habitat	Statusi IUCN
Pyrgus andromedae	Alpine Grizzled Skipper	Hesperida alpine	Alpijska hesperida		I, e rrezikuar
Pyrgus sidae	Yellow-banded Skipper		Lipicina hesperida		I,e ndjeshme
Lycaenidae – Gossamer-winged butterflies					
Aricia anteros	Blue Argus		Alpijski plavac		I, e rrezikuar
Cupido minimus	Little Blue		Maleni plavac		I,e ndjeshme
Iolana iolas	Iolas Blue		Pucavac		I, e rrezikuar
Lycaena dispar	Large Copper	Flutura ngjyrëbakër	Veliki dukat	Shtojca II, IV	I,e ndjeshme
Maculinea alcon	Alcon Blue		Mali pegavac		I,e ndjeshme
Maculinea arion	Large Blue		Veliki pegavac	Shtojca II, IV	I,e ndjeshme
Plebeius argyrognomon	Reverdin's Blue		Blistavi plavac		I,e ndjeshme
Polyommatus eroides	False Eros Blue		Planinski plavac	Shtojca II, IV	
Pseudophilotes baton	Baton blue				I, e rrezikuar
Pseudophilotes bavius	Bavius Blue		Zagasiti plavac	Shtojca IV	I, e rrezikuar
Satyrium acacie	Sloe Hairstreak	Flutura e sallgamit	Mali repkar		I,e ndjeshme
Satyrium w-album	White-letter Hairstreak		Šumski repkar		I, e rrezikuar
Thecla betulae	Brown Hairstreak		Brezov dukat		I,e ndjeshme
Nymphalidae – Brush-footed butterflies					
Apatura ilia	Lesser Purple Emperor		Mali prelivac		I,e ndjeshme
Apatura iris	Purple Emperor		Modri prelivac		I, e rrezikuar
Argynnis pandora	Cardinal		Pandorina sedefica		I, e rrezikuar
Brenthis ino	Lesser Marbled Fritillary		Inova sedefica		I, e rrezikuar
Erebia gorge	Silky Ringlet		Zagasita erebija		I, e rrezikuar
Erebia rhodopensis	Nicholl's Ringlet	Flutura rodopense	Rodopska erebija		I, e rrezikuar
Euphydryas aurinia	Marsh Fritillary		Mocvarna sedefnica	Shtojca II	I,e ndjeshme
Limenitis populi	Poplar Admiral		Veliki topolnjak		I, e rrezikuar
Nymphalis antiopa	Camberwell Beaty		Kraljev plašt		I, e rrezikuar
Satyrus ferula	Great Sooty Satyr		Veliki satir		I,e ndjeshme
Papilionidae – Swallow-tail butterflies					
Papilio machaon	Swallowtail	Flutura bajrake	Lastin repak		I, e rrezikuar
Parnassius apollo	Apolon	Apollo flutura	Apollo	Shtojca IV	I,e ndjeshme
Zerynthia polyxena	Southern Festoon	Flutura me ilikë	Uskršnji leptir	Shtojca IV	I,e ndjeshme
Pieridae – Pierid Butterflies					

Speciet (të renditura sipas familjeve)	Emërtimi Anglisht	Emërtimi shqip	Emërtimi sërbisht	Direktiva e BE-Habitat	Statusi IUCN
Euchloe ausonia	Eastern Dappled White		Cipkasti belac		I, e rrezikuar
Pieris brassicae	Large White	Flutura e lakrës	Veliki kupusar		I, e ndjeshme

Insektet akuatike (bazuar në mostrat e marra nga UNDP në pranverë 2011):

Krahas specieve të shpeshta, mund të identifikohen edhe tri specie shumë të rralla në lumenjtë e Dragashit:

- Limnephilus petri gjendet në lumin Brod dhe është specie tipike për Gadishullin Ballkanik që është i pranishëm vetëm në Kosovë (në Kosovë vetëm në pjesën e sipërme të Lumit Brod) dhe në Bullgari.
- Genus Trianodes gjendet në Liqenin Brezna dhe është lloji i vetëm deri tani në Kosovë.
- Specie gjinia femër e llojit Notidobia është gjetur në përronjtë e vegjët në pjesën e sipërme të deponisë së mbeturinave në fshatin Buzez. Ky lloj i takon grupit të specieve tipike Ballkanit (Notidobia melanoptera, Notidobia bizensis apo Notidobia nogradorum).

Këto rezultate të pakta të insekteve akuatike në komunën e Dragashit tregojnë për një faunë të pasur dhe specifike për këtë zonë. Është e nevojshme të mblidhen më shumë insekte nga ky grup në mënyrë që kjo të trajtohet në kuadër të çështjeve të konzervimit dhe manaxhimit.

Amfibiet dhe zvarranikët

5 amfibia (të gjitha speciet Shtojca IV) dhe 6 specie zvarranikësh (5 specie Shtojca IV) janë lokalizuar. Meqë nuk ka inventar sistematik për këtë zonë, këta numra janë vetëm informata. Rregjistrimet e konsiderueshme mund të priten nga studimi sistematik (shih Tabela 12).

Tabela 12: Amfibiet dhe speciet e zvarranikëve të regjistruara në Dragash me Statusin IUCN, e rrezikuar ose e ndjeshme në Shtojca II apo IV të Direktivës së BE-së Habitat

Speciet	Emërtimi anglisht	Emërtimi shqip	Emërtimi sërbsisht	Direktiva e BE-së Habitat	Statusi IUCN
Amphibians					
Bombina variegata	Yellow-bellied toad	Bretkoca barkverdhë Bretkoca e drunjve-gargaliqi	Žutotrbi mukac	Shtojca IV	LC-Least concern
Hyla arborea	Tree frog	Bretkoca e drunjve-gargaliqi	Gatalinka	Shtojca IV	LC-Least concern
Rana dalmatina	Agile frog	Bretkoca e pyllit	Šumska žaba	Shtojca IV	LC-Least concern
Rana graeca	Greek frog	Bretkoca greke	Grcka žaba	Shtojca IV	None

Speciet	Emërtimi anglisht	Emërtimi shqip	Emërtimi serbisht	Direktiva e BE-së Habitat	Statusi IUCN
Salamandra salamandra	Common Fire Salamander	Salamandri zi e verdhë	Šareni daždevnjak	Shtojca IV	Least Concern
Reptiles					
Anguis fragilis	Slow-worm	Kokëzogëza	Slepić		
Lacerta agilis	Sand lizard	Hardhuca e shpejt	Siva gušterica	Shtojca IV	LC-Least concern
Lacerta muralis	Wall lizard	Hardhuca e mureve	Zidni gušter	Shtojca IV	
Lacerta viridis	Green lizard	Hardhuca e gjelbër	Zelembac	Shtojca IV	
Natrix natrix	Water snake	Gjarpri i barit, bollujca, bollujësa	Belouška	Shtojca IV	CR-Critically I, e rrezikuar
Vipera ammodytes	Viper snake	Neperka	Poskok	Shtojca II, IV	LC-Least concern

Rreth 94% e komunës është habitat i gjitarëve, zogjëve dhe fluturave sipas Direktivës së BE-së Habitat (përfshirë Direktivën për Zogj – EU 2007 dhe 2009). Përveç habitateve alpine për dhitë e egra, subalpinet, pyjet e larta dhe ekotonet për tranzicionin pyll – fushë janë korridore ekologjike për rrëçebulli, arinj dhe ujqi që lidhin zonat malore të Parkut Nacional të Sharrit me malet e Maqedonisë dhe Shqipërisë. Kjo vërteton të gjeturat (dhe jep detaje shtesë) të identifikimit preliminar të Vendndodhjeve Natura 2000 në Kosova (B. Mustafa et al. 2009).

Resurset faunistike janë pjesë e informatës për të sugjeruar zgjerimin e Parkut Nacional dhe definicionin e ardhshëm të llojeve të ndryshme të zonave dhe specieve të mbrojtura sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (rezervat i natyrës, zoën e posaçme, AZHQ dhe SAC, monument natyror dhe pejsazhe të mbrojtura. Korridoret ekologjike luajnë një rol të rëndësishëm që mundëson lëvizjen e lirë të specieveve nga një pjesë në pjesën tjetër përbërëse të rrjetit ekzistues ekologjik.

4.6 Pejsazhi

Pejsazhi i Komunës së Dragashit është krijuar gjatë shekujve të ndikimit njerëzor dhe karakterizohet me bar natyror-shkurrishte të përziera sipërfaqe shkëmbore , lagështira dhe pyje. Këto tri lloje kryesore të shfrytëzimit të tokave përbëjnë rreth 60% të sipërfaqes komunale. 39% e tokave shfrytëzohet për qëllime bujqësore. Për shkak të lartësive fushat dominohen nga tokat e lëruara dhe kulturat permanente (30% versus 9%). 1% e sipërfaqes është e mbuluar me vendbanime dhe infrastrukturë (shih Tabela 13 dhe Figura 11).

Tabela 13: Llojet e shfrytëzimit të tokave në pellgjet e lumenjve të Dragashit

Nën-pellgu	vendbanimet	Zonat bujqësore	Kullotat dhe livadhet	Pyjet	Bari natyror & shkurrishtet	Zonat rrallë të vegjetuara	Shjkëmbinj të jashjtëm	Lagshinat	Trupa ujqor	Totali në ha
